



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
Kuvendi i Komunës
-Kryesuesi i Kuvendit-

01Nr. 60/01-24557/23
Kaçanik, 18.09.2023

FTESË PËR MBLEDHJE

Të nderuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës,

Në bazë të nenit 43 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, e thërras mbledhjen e VIII (tetë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2023.

Mbledhja do të mbahet në sallën e kuvendit të komunës, në katin e tretë të objektit të komunës, me 27 shtator 2023 (e Mërkurë) në ora 11:00.

Mbledhjen do ta kryeson dhe udhëheq Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Ju mirëpresim!

Me respekt!

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të datës 27.09.2023 do të shqyrtohet ky:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Propozim Vendimi për Buxhetin e Komunës së Kaçanikut, për vitin fiskal 2024 dhe vlerësimet për vitet 2025-2026;
3. Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023;
4. Propozim Vendimi për transferin e mjeteve buxhetore, sipas buxhetit të vitit 2023;
5. Propozim Vendimi për realizimin e një vizite studimore e anëtarëve të KK, në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Malit të Zi;
6. Raporti i punës i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), për gjashtëmujorin e parë të vitit 2023;
7. Propozim Vendim për miratimin e Raportit përfundimtar të Komisionit profesional të komunës, për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e breshërit të datës 23.07.2023 në territorin e Komunës së Kaçanikut, në fshatin Biçec;
8. Propozim Vendim Paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës, në shfrytëzim afatshkurtër, në ZK Kaçanik;
9. Propozim Vendim për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës;
10. Propozim Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pronës private 00153-24 të Razim Shaqiri, për këmbim me pronën komunale 01908-15, në ZK Kaçanik;
11. Propozim Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pronës private 00643-0 të Adnan Vishi, për këmbim me pronën komunale 00644-1, në ZK Kaçanik;
12. Propozim Vendim për shpallje me interes të përgjithshëm publik të pronës private 00544-0 të Mejdi Xhokli, për këmbim me pronën komunale 00545-0, në ZK Koxhaj.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr. 60/01-17845/23
Kaçanik, 31.07.2023

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VII (shtatë)** e rregullt e Kuvendit të Komunës Kaçanik për vitin 2023 (Legjislatura e shtatë), mbajtur me 31 korrik 2023. Mbledhja u mbajt në katin e tretë të objektit të komunës, në sallën e kuvendit, në ora 11:00.

Nga përberja e përgjithshme e Kuvendit të Komunës prej 27 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 27 anëtarë – të gjithë.

Nga Ekzekutivit i Komunës, në mbledhje morën pjesë: Kryetari i Komunës, Besim Ilazi, Nënkryetari i Komunës, Sabedin Vishi, Drejtoret e drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Ramadush Osmani-DSHPE, Qamil Stagova- DUKMM, Suhad Dullovi- DBPZHR, Dardana Tafili-Dauti-DAP, Pranvera Loku-Zharku- DZHET, Sali Malsiu-DSHMS, Hafize Sallahi-DKRS, ndërkaq nga zyrtarët e komunës në kuadër të detyrave të punës ishin: Bejtulla Dalloshi, Fatlume Guri-Selimi.

Nga strukturat vendore mbledhja monitorohet përmes Teleprezencës nga Vjosa Ahmetaj – MAPL Mbledhja ka transmetim të drejtpërdrejtë.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit
Procesmbajtës, Mavije Murseli.

Kryesuesi i Kuvendit : Të nderuar pjesëmarrës, së pari iu përshëndes të gjithëve, iu dëshiroj mirëseardhje, konstatoj kuorumin, të gjithë janë prezentë, kushte pune për mbajtjen e mbledhjes ka, e hapi mbledhjen e VII (shtatë) të rregullt të Kuvendit të Komunës për vitin 2023.

Para se të filloj me leximin e rendit të punës, dëshiroj të konfirmoj se në dy vendimet e mbledhjes së kaluar, njëri për formimin e komisionit dhe njëri vendim paraprak për dhënien e pronave në shfrytëzim, të premtën në mesdite nga MAPL, na është kthyer në rishqyrtim, pasi që në muajin gusht ne nuk kemi seancë, jemi në pushim. Afati ligjor për rishqyrtim të këtyre vendimeve është 30 ditë prandaj ne duhet ti trajtojmë dhe ti shqyrtojmë sot. Paraprakisht ju njoftoj se tek vendimi paraprak për dhënien e pronave në shfrytëzim, MAPL ka kërkuar që të ndahen në dy vendime, konkretisht të ndahen pronat që jepen në periudhë afatgjatë dhe pronat në periudhë afat shkurtër sepse në vendimin e kaluar kanë qenë në një vendim të gjitha. Njashtu edhe tek formimi i komisionit kanë kërkuar të formohet komision i veçantë për secilin vendim, edhe për pronat afatgjatë dhe ato afat shkurtër. Gjithashtu edhe tek vendimi për formimin e komisionit kanë thënë që i njëjti komision nuk mundet me i shqyrtua dy propozim vendimet. Lidhur me këto komisione MAPL ka kontestuar nenin për pagesën e natarëve të komisionit. Për shkak çështjes së afatit ligjor të cilin e ceka edhe më lart edhe njëherë ju pyes a jeni të pajtimit që ti trajtojmë këto dy pika në këtë mbledhje.

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës;
2. Raporti Gjashtëmujor financiar për periudhën Janar – Qershor 2023;

3. Propozim Vendim për vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private, ZK Runjevë ;
4. Propozim Vendim për vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ,ZK Begracë;
5. Propozim Vendim për ndryshim plotësimin e Vendimit 01Nr.60/01-33331/22 ,të datës 29.12.2022 - Për ndryshim plotësimin e vendimit të kuvendit të komunës 01NR.104/02-19963 ,të datës 02.09.2022 - Për formimin e komisionit të ankesave për procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
6. Propozim Vendim për ndryshim plotësimin e Vendimit paraparak 01Nr.104/02-13790/23,të datës 30.06.2023 Për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër;
7. Propozim Vendim për ndryshim plotësimin e Vendimit 01Nr.104/02-13788/23, të datës 30.06.2023 Për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.

Lidhur me rendin e punës e hapi diskutim:

z. Agim Mani: Megjithëse ka qenë dashtë ma herët me na njoftua është pak me vonesë.

z. Adnan Reka: Ne sot a do të marrim dy vendime për dhënien e pronës afatgjatë dhe afatshkurtër.

Kryesuesi i Kuvendit : Vendimi qe është këtu është vendim edhe për afatgjatë dhe afat shkurtër .Ne ketë vendim e plotësojmë ndryshojmë dhe e bëjmë vendim paraparak vetëm për afatgjatë sepse kërkesa e MAPL, ka qenë nuk mundet me një vendim me u përfshi edhe për afat shkurtër edhe afatgjatë sepse janë dy procedura të ndara ,afat shkurtër jemi duke e hekur krejt jemi duke e lenë për ma vonë.

Atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 27. Në saje të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

APROVOJ

Rendin e punës në përbërje prej 7 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikëve sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kuvendit të Komunës

Vërejtjen në Procesverbal paraqiti z. Adnan Reka: Në mbledhjen e kaluar paraprake konkretisht në mbledhjen e 5-të, kam bërë dy pyetje për të cilat nuk kam marrë asnjë përgjigje andaj pse duhet të vazhdojë të bëj pyetje përderisa asnjëherë unë nuk marr ndonjë përgjigjeje, po ashtu asnjëra nga këto pyetjet e mija nuk janë evidentuar në procesverbal.

Pyetjet e mija kanë qenë: Përkundër faktit qe shkolla fillore “Emin Duraku” është e vjetër dhe për kundër renovimit në vitin e kaluar të tualeteve në atë shkollë, tualetet në gjendje të keqe dhe primitive mbeten shqetësim i madh për fëmijët dhe prindërit e tyre e aq më tepër për fëmijët me nevoja të veçanta që ndjekin mësimet në atë shkollë. Si rezultat i gjendjes së keqe të këtyre tualeteve, andaj kërkojë që të ndërmerrni masat e nevojshme në mënyrë që të mos iu cenohet e drejta për shkolim fillor këtyre fëmijëve, konkretisht fëmijëve me nevoja të veçanta të cilët janë të ndjeshëm për shoqërinë.

2.Çfarë po ndodh me rrugën diaspora, e cila nuk është asfaltuar deri tani. A ka gjasë qe kjo rrugë të përfundojë më shpejtë duke marrë parasysh faktin qe kjo rrugë i përket zonës tatimore një apo dy.

3. Lidhur me disa ndryshime te korniza afatmesme buxhetore e komunës se Kaçanikut, pas fjalës së kryetarit të komunës kam pyetur se a është kriter numri i nxënësve të shkollës mbi 250

e jo mbi 200, që do të thotë kjo duhet të përmirësohet. Gjithashtu pas fjalës se z. Selajdin Tronit kam cituar se nuk janë më tepër se 250 nxënës.

Kryesuesi i Kuvendit: Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KK e shtroj në votim për aprovim me vërejtjet e Adnan Reka dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Në sajë të kësaj del konstatimi së Kuvendi i Komunës,

APROVOJ

Procesverbalin e mbledhjes së VI (gjashtë) të Rregullt të Kuvendit të Komunës Kaçanik, të datës 30.06.2023 / Lënda: 01Nr. 60/01-14754/23.

Procesverbali do të publikohet i korrigjuar.

Kryesuesi i Kuvendit: Kalojmë në pozicionin e Pyetjeve dhe Kërkesave:

Pyetje dhe Kërkesa

z. Adnan Reka: Para se të kalojë tek kërkesat, fillimisht kërkojë nga kryesuesi i kuvendit që të bëhet më i vëmendshëm dhe më i përgjegjshëm si Kryesues i këtij Kuvendi, të sigurojë që pyetjet dhe kërkesat që NE asamblistët si përfaqësues të qytetarëve që i shtrojmë në këtë Kuvend të mos hasin në vesh të shurdhër, është përgjegjësi kryesuesit të gjej mekanizma që ta obligojë administratën komunale të kthej përgjigjeje me kohë për secilën pyetje apo kërkesë dhe për secilin asamblistë, pa dallim dhe pa diskriminim. Mendojë që është më mirë ta obligojë ekzekutivin të kthej përgjigjeje se sa të flasë në emër të tyre.

Tani po e shtroj kërkesën që kam nga banorët dhe pronarët e bizneseve të vogla të lagjeve “Qamil Ilazi” dhe “Sali Bajra”.

Ndonëse, këtë kërkesë banorët e këtyre lagjeve e kanë adresuar si **ankesë** edhe tek Kryetari i Komunës dhe Drejtori i Shërbimeve Publike, ata kanë kërkuar që përmes meje këtë kërkesë ta adresojnë edhe në Kuvend, duke e konsideruar Kuvendin Komunal si organin më të lartë dhe më përgjegjës për shqetësimet e tyre.

Kërkesa e tyre është, rikthimi i rrugëve “Qamil Ilazi” dhe “Sali Bajra” në rrugë dy dykahore dhe heqja e parkingjeve përgjatë trotuarit. Një vendim i tillë i pamenduar mirë sjell shumë probleme, së pari është ndesh me ligjin e trafikut rrugor, më pas pengon tej mase qarkullimin e bizneseve, krijon vështirësi të mëdha për qarkullimin e lirë të banorëve të këtyre lagjeve dhe shumë probleme të tjera që banorët edhe vetë i kanë cekur në këtë ankesë që do të ju dorëzoj një kopje.

Pyetja tjetër, a janë sqaruar dy kërkesat e Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, për rishqyrtimin e vendimeve të kundërligjshme, vendimi 01Nr. 104/02-9142/23 i datës 28.04.2023 për shpallje me interes të përgjithshëm publik dhe vendimi 01Nr. 104/02-11896/23 të datës 30.05.2023, për caktimin e lokacionit për nevoja të HANDIKOS.

Kryesuesi i Kuvendit: Të lutem orientohuni te pyetjet dhe kërkesat. Unë përgjigjem në pyetjet që më drejtohen mu andaj publikisht kam kërkuar dhe kërkojë nga të gjithë drejtorët-ekzekutivi dhe kryetari që të përgjigjen në kërkesat e anëtarëve kuvendit.

znj. Ardita Rrahmani: Kam dy shqetësime të cilat do ti adresoj dhe nuk po besoj që duhet të kaloj muaji për të marr një përgjigje.

Meqenëse drejtorët janë të pranishëm këtu është një problem serioz me të cilin po ballafaqohemi çdo ditë, fillimisht po vazhdoj me problematikën e mushkonjave që në këtë vit ka qenë shqetësim për çdo individ dhe familje në gjithë komunën Kaçanikut. Në bazë të kontakteve me komunat e tjera jemi ndër komunat e vetme në Republikën e Kosovës që nuk e kemi bërë dezinfektimin e komunës gjatë sezonës së verës. Shqetësimet e tilla i kam adresuar edhe muaj më parë por deri më tani asnjë përgjigjeje nuk e kemi marrë prandaj bëj apel sepse ende ballafaqohemi me këtë shqetësim dhe kërkojë të bëni dezinfektimin e komunës sepse vetëm 210 km² i kemi.

Shqetësimi i dytë ka të bëjë me shndërrimin e rrugës njëkahore në qytet dhe shndërrimin e gjysmës së rrugës në parking, a jeni të vetëdijshëm se çfarë kaosi po bëhet në qytet sidomos në orët e vona të mbrëmjes ku qarkullimi i veturave është tejet i madh si dhe fluksi i qytetarëve dhe mërgimtarëve është në pikun e saj gjatë muajve korrik dhe gusht. Ngushtica e asaj rruge paraqet vështirësi edhe në qarkullimin e veturave të ambulancës edhe në raste emergjente dhe sa për rikujtim pjesa me e dendur me qytetarë dhe banorë është pikërisht në rrugën që nis në “Qamil Ilazi”.

Naim Beqa: Duke parë shqetësimin për veturat pasi që janë bërë rrugët njëkahore , kërkojë nga drejtori i shërbimeve publike që ta rivlerëson situatën që ka krijuar kjo gjendje dhe po ashtu ta vlerësojë nëse këtu kjo situatë sjell pozitivitet a po negativitet. Në anën e majte të kësaj rruge Qamil Ilazi dhe Sali Bajra janë bërë vend parkingjet të cilat sipas rregullores dhe procedurave të policisë së Kosovës ato janë ilegale për arsye se ato janë të vendosura përballë shtëpive apo dyerve të shtëpive të qytetarëve që banojnë aty.

Çështje tjetër serioze janë edhe mbi kanalizimet, ku qytetarëve ju ka pamundësuar qarkullimi i lire prej daljes së shtëpive të tyre. Kërkoj nga organet kompetente që ta rishqyrtojnë edhe njëherë vendimin që kanë marrë dhe pyetja ime është, kjo problematikë a është dashtë me dal në kuvend për diskutim, duke marrë parasysh edhe faktin që edhe ne të gjithë jemi anëtar të kuvendit komunal nga partitë e ndryshme!

2. Pse ende dritat që një vit nuk janë rregulluar në rrugën “Sali Bajra” dhe kanalizimi aty që ka qenë afër çerdhes që është tu bërë sheshi nuk është mbuluar?

3. Gjatë rrugës tek ura e Rakocit, çdo herë që bie shi, uji bien në anën e djathtë të urës dhe ju hyn qytetareve nëpër shpija në rrugën “Sali Bajra”. A duhet të rregullohet ana e majtë e kësaj pjese, pasi që asfalti është në anën e djathtë pra në anën e kundërt të përroit, a do të ndërmerret ndonjë masë sa ma shpejt nga komuna me qëllim që në kohërat e shirave të mos pësojnë qytetarët nga dëmtimi i shtëpive të tyre nga ujërat.

z. Agim Mani : Është bërë një kërkesë nga fshati Semaj lidhur me çështjen e ndriçimit publik, pasi që dy vite ata ballafaqohen me problemin e rrjetit elektrik me defekte të shpeshta.

Kam qenë në vendin e ngjarjes dhe kam vërejtur që në katër shtyllat elektrike ka defekte ku dritat dhezen dhe ndalen pandërprerë, me ç’rast në kohën e mbrëmjes banorët e fshatit e kanë të pamundur të qëndrojnë në oborr. Duke marrë parasysh shkaku që është një pengesë shumë e madhe, banorët e fshatit Semaj që dy vite kanë bërë kërkesë për zgjidhjen e këtij problemi mirëpo deri me tani nuk është ndërmarrë asnjë veprim. Prandaj kërkoj nga drejtori i shërbimeve publike të dal në vendin e ngjarjes ta shikon, sepse me të vërtetë është problem shumë serioze, duke marrë parasysh edhe faktin që banorët për shkak të pengesës të madhe kanë tentuar me i thye dritat.

znj.Kadrije-Lika-Troni: Në seancën e fundit kam bërë një pyetje për drejtorin e arsimit, aty u pata ndërlidh me atë që një ditë para festës në çerdhen “Agimi”, pasi pranohen fëmijët d.m.th. ju shkon njoftimi se duhet të pushojnë prej orës 12:00 pra e kanë të lirë, ajo ka shkaktuar një kaos tek prindërit të cilët kanë qenë të punësuar jashtë qytetit të Kaçanikut, se si me organizua atë ditë për me i marrë fëmijët. Përgjigjen që kam marrë nga drejtori është një mënyrë e shpërblimit për punën që bëjnë, për punët që i bëjmë ne të gjithë paguhemi mirëpo mënyra e shpërblimit nuk mund të jetë kur me një anë shpërblehen punëtorët dhe tjetrën anë ndëshkohen prindërit dhe fëmijët.

z.Agim Çaka: Edhe pyetja ime ndërlidhet me shqetësimin e disa prej kolegeve lidhur me rrugën njëkahore dhe parkingun i cili është paraparë në atë rrugë, jo vetëm pse e përmendën këtu koleget por edhe tek diskutimi me qytetarët dhe me bizneset e kam vërejtur që ky vendim ka qenë mjaft problematik. Mua më intereson kush është “ai” që mori këtë vendim d.m.th. nga lindi kjo ide dhe kush e ka marrë këtë iniciativë?

Pyetja tjetër ka të bëjë me shkallët tek guri i shpumë, a ka ndonjë projekt për këtë?

z. Betim Shala: Unë i kam dy kërkesa një për kryetarin e komunës dhe një për drejtorin e urbanizimit. Sa i përket kryetarit të komunës, a mund ta formoj një komisioni i cili merret me këta që janë duke i kryer punët në hekurudha sa i përket rrugës “ Skënderbeu” një pjesë e trotuarit njërën anë është zgjeruar dhe njërën anë me lan parking .

Kërkesa tjetër për drejtorin e urbanizimit, a keni mundësi ta bëni një projekt për rehabilitimin e rrugës në mëhallën Rakoc në hyrje, sepse aty është shumë ngushtë dhe një pjesë e murit duhet me u heq që me u zgjerua rruga.

z. Bashkim Luma: Në kuadër të drejtorisë shërbimeve publike në fshatin Gllloboçicë, vazhdon të mbetet shqetësim i madh problematika e rrjetit të ndriçimit publik edhe pas disa muajsh do të thotë përkundër faktit që rrugët nuk janë të mbuluara me prioritet me ndriçim publik edhe ato rrugë cilët janë përfunduar me ndriçim publike edhe aty ka pengesa të shumta si shkak i mos mirëmbajtjes së atyre dritave. Një ashtu rruga ndër komunale që lidh komunën Kaçanikut me atë të Hanit të Elezit edhe pas disa viteve si projekt i përfunduar nuk ka pasur mirëmbajtje dhe si e tillë shkakton probleme të ndryshme si p.sh. në komunikacion vjen deri tek aksidenti i shumë veturave.

Nga drejtoria e arsimit meqenëse si pyetje e pata parashtruar për faktin që ka mungesë të kuadrit të arsimit në fshat. Në shkollën fillore “Gafurr Luma” dhe në shkollën “Dituria” në fshatin Strazhë, është mjaft shqetësuese mungesa e mësimdhënësve të lëndës së fizikes dhe kimisë dhe pasi që vazhdon kjo mungesë e tillë, kërkojë nga kjo drejtori që të hap konkurse për pranimin e mësimdhënësve të caktuar sepse në raste të ndryshme është një diskriminim ndaj nxënësve meqenëse në test të cilët po mbahen mbas mbarimit të klasës së nëntë faktikisht njëra prej lëndëve e cila është shumë prioritet, është ajo e kimisë dhe fizikes, nxënësit e shkollave kanë mungesë të diturisë bazike për këta lëndë.

Kryesuesi i Kuvendit: Pyetje dhe Kërkesa tjera nuk ka, atëherë kalojmë në pikën e dytë:

2. Raporti Gjashtëmujor financiar për periudhën Janar – Qershor 2023;

Materialin e keni marrë, para se me hap diskutimin , fjalën e ka drejtori i DBF, Bahri Selimi:

z. Bahri Selimi: Në kuadër të llogaridhënies edhe pse e kam përgatitur raportin gjashtë mujor Janar- Qershor 2023, jemi munduar në pika shkurta ta tregojmë ecurinë financiare të komunës lidhur me inkasimin e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore. Në fillim të raportit e keni vërejtur sa është buxheti miratuar dhe sa është buxheti aktual. Buxheti aktual është rritur për pjesën apo masën monetare të të hyrave të bartura nga viti 2022 në vitin 2023, ndërsa ende pa u bartur është pjesa e të hyrave të vitit 2021. Në raportin tjetër Janar –Shtator do ta keni edhe pjesën e të hyrave nga viti 2021 në vitin 2023, pasi që tani jeni në dijeni që Ministria e Financave tani e ka humbur luftën karshi komunave sepse këto të hyra ligjërisht i kanë takuar me kohë komunave, mirëpo i ka stopua deri tani kjo ministri.

Te raporti i të hyrave direkte mund të vëreni që është bërë një inkasim i mirë apo përfundim i mirë i të hyrave vetanake, te shumica e të hyrave përqindja e realizimit është 60.66%, vetëm i të hyrave direkte kryesisht lejet e ndërtimit kanë një performancë më të lartë dhe tatimi në pronë, shumë pak prej të hyrave apo lloje të të hyrave kemi ngecje në realizim .

Tek shpenzimet kemi një ngritje të përfomancës financiare, në të gjitha kategoritë ka rritje në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar d.m.th. kemi 33% realizim më shumë apo 36,23% e buxhetit është shpenzuar deri më tani.

Buxheti sipas kategorive ekonomike, për pagat dhe mëditjet janë shpenzuar 53%, për kategorinë e mallrave dhe shërbimeve 25%, shpenzimet komunale 21%, subvencionet dhe transferet 28% dhe shpenzimet kapitale 15%.

z.Agim Mani: Ky raport financiar për periudhën janar–qershor të vitit 2023, është një informatë tregues i cili pasqyron punën e ekzekutivit komunal gjatë kësaj periudhe, konkretisht

na mundëson që ne ta shohim planifikimin e buxhetit, realizimin dhe shpenzimet komunale të ndara në anën buxhetore duke filluar nga zyra e kryetarit dhe të gjitha drejtoritë.

Buxheti i miratuar në vitin 2023 ka qenë 9.674.689 euro dhe me vonë pas bartjeve të te hyrave vetanke të vitit 2022 ka arritur vlerë prej 11,178,263.91euro, d.m.th. siç e dimë nga granti qeveritar 91.9% dhe nga të hyrat vetanke janë 8.08%, d.m.th. te hyrat vetanke që është pjesë e komunës dhe është për tu përshëndetur ndërgjegjia e qytetareve që kanë kryer obligimin e tyre. Siç e potencoj dhe drejtori tatimin në pronë, planifikimi i ekzekutivit ka qenë 250.000.00 euro ndërsa qytetarët e kanë paguar tatimin në pronë 218.000.00 euro apo 87%, kjo d.m.th. është shumë e mirë që qytetarët e kanë kuptuar që e kanë obligim megjithëse ma herët ka pas disa mjegullina ndaj komunës dhe ministrisë mirëpo realisht gjendja faktike nuk qëndron ashtu sepse qytetari e kupton që një obligim patjetër duhet me krye që i takon ndaj komunës. Siç e dimë në kohën e fundit ministria ka marr vendim që tatimi në pronë të bëhet nga 100 euro për të gjithë qytetarët apo tatimpaguesve dhe besojë që në vitin e ardhshëm do të ju kompensohet kjo shumë e qytetarëve që kanë paguar këtë vit.

Te të hyrat vetanake përveç tatimit në pronë që kanë arritur 87% të inaksohen dhe te taksat për lejet e mjedisit edhe këta e ceki edhe drejtori, këtu unë mendoj që fillimisht ka qenë një keq planifikim i ekzekutivit sepse këtu keni planifikuar të mblidhen 3,000.00 euro ndërsa janë mbledhur 10,000.00 euro d.m.th. kjo është keq planifikim, te shfrytëzimi i pronës publike keni planifikuar ti mblidhni 15,000.00 euro dhe i keni mbledh 3,600.00 euro d.m.th. vetëm 24% nga shfrytëzimi i pronave publike që i keni dhanë, te parkingjet publike i keni planifikuar ti tuboni 7,000.00 euro kurse në këtë raport nuk e keni inkasua asnjë d.m.th. zero, nuk e di se a është e vërtetë a qëndron ky realitet apo nuk jeni harmonizuar me drejtorin e shërbimeve publike sepse në raportin tre mujor te parkingjet thuhet se te parkingjet janë inkasuar 550.00 euro ndërsa në raportin gjashtë mujor thuhet se është 0 (zero), te administrata e përgjithshme gjegjësisht te cërkatat e lindjes i keni planifikuar 12,000.00 euro ndërsa keni inkasuar 732.00 euro ose 6,10% , kjo nuk i përket realitetit ose keni bërë gabim brenda grumbullimit të kodeve sepse këtë gabim e keni përsërit nga viti i kaluar edhe auditori e ka dhënë një vërejtje për këtë por ju përsëri e keni vendos gabimin e njëjtë. Në total të te hyrave vetanake 862,578.00 euro janë inkasuar 524 kanë arritur shumën 60%, mirëpo ky raport është i mangët nga të hyrat vetanake dhe kjo është si pyetje drejtor, pse nuk i keni sqaruar sa mjete janë inkasuar nga gjobat e trafikut dhe gjobat e gjykatës, nuk është në këtë raport te të hyrat indirekte që janë.

Lidhur me shpenzimet e buxhetit , përveç pagave dhe mëditjeve është për keqardhje me than te shpenzimet kapitale të planifikuara prej 3 milion 3203, keni shpenzuar vetëm 491,000.00 euro d.m.th. 14%, kjo situatë e prek më së shumti qytetarin, sepse këtu qytetari ka nevojë shtrimin e rrugëve për investime kapitale më shumë dhe këtu i keni stagnuar dhe nuk nëse shkohet me këtë trend nuk keni me mund me i realizuar as 50%, do të ju ndodh sikur në vitin e kaluar dhe do të ju shkojnë paret për suficit.

Te shpenzimet e mallrave dhe shërbimeve do te fokusohem tek disa shifra më të larta që kanë qenë, te mirëmbajtja e rrugëve lokale vetëm për gjashtë muaj keni shpenzuar 148,666.00 euro kur e dimë që viti aktual apo viti i kaluar nuk ka pasur të reshura atmosferike, nuk ka pasur borë dhe ju i keni shfrytëzuar 148,000.00 euro. Ne të gjithë e dimë se si është duke u bërë mirëmbajtja e rrugëve, ku do që shkoni nëpër rrugë kanë dalë gjethet për rreth rrugëve dhe nuk pastrohen, sajimi i dëmeve nëpër rrugë nuk mund me qenë aq i kushtueshëm sa që me shpenzua prej këto 148,000.00 euro, shtrohet një sipërfaqe e madhe e rrugëve te investimet kapitale siç e ceka më herët, prapë po fokusona te rregullimi i asfaltimit në pjesën urbane në Kaçanik, ku i keni planifikuar 140,000.00 euro ndërsa për gjashtë muaj ditë i keni shpenzuar 7,498.00 euro, ndërsa për rregullimin dhe asfaltimin në pjesën rurale në Kaçanik, i keni planifikuar me i realizua 190,000.00 euro ndërsa i keni shpenzuar vetëm 22,000.00 euro dhe te ndërtimi i objektit të banimit social janë planifikuar 280,000.00 dhe janë shpenzuar vetëm 85,000.00 euro që d.m.th. e gjithë kjo paraqet një keq planifikim të buxhetit.

Rrustem Zenuni – Ne e kemi shikuar raportin financiar gjashtë mujor për periudhën janar-qershor të vitit 2023, përveç që qytetarët janë përgjigj pozitiv, ky është një indikator që tregon se kryerja e obligimit të qytetarëve ndaj tatimit në pronë dhe taksave tjera shpreh edhe besimin

e qytetareve që kanë ndaj institucioneve komunale dhe kjo është një punë për tu lavdëruar, po ashtu rezultat pozitiv ka pas edhe inkasimi i të hyrave nga lejet e ndërtimit.

Agim Caka- Vërehet që te pagat dhe mëditjet niveli i shpenzimeve është 53.59%, kjo është pasqyra ma reale se si duhet shpenzohet buxheti, mirëpo problemi është te mjetet e kategorive të tjera ekonomike se si duhet të shfrytëzohen siç janë kategoria e mallrave dhe shërbimeve, shpenzimet komunale, subvencionet dhe transferet dhe sidomos problemi kryesor qëndron te kategoria e shpenzimeve kapitale 17.14% . Niveli i ulët i shpenzimeve kapitale tregon që kemi shpenzuar një shumë të vogël të mjeteve monetare në gjashtë mujorin këtij viti, nga këtu rrjedh që në gjashtë mujorin e dytë të këtij viti ne detyrohemi ti shpenzojmë të gjitha mjetet e mbetura nga kjo kategori ekonomike, ku për një periudhë kaq të shkurtër nuk mund të shpenzohen në mënyrë adekuate sepse për një periudhë kaq të shkurt kohore nuk mund të bëhen planifikime të mirëfillta të projekteve dhe gjithsesi kanë me reflektua te qytetarët si projekte të dështuara.

Selajdin Troni – Dua të ndërlihem te pjesa e raportit financiar për parkingjet, Agim e kam pyetur drejtorin d.m.th. kur janë zero inkasimet, d.m.th. parkingjet kanë qenë me kompensim te pjesa e mirëmbajtjes së taksave.

Agim Mani : Shiqo Selajdin, të planifikuara kanë qenë 17 milion inkasime d.m.th. inkasimi është 0 (zero) nëse shikohet raporti tre mujor janë inkasuar 550.000.00 euro, andaj pyetja ime është se ku kanë mbetur 550.000.00 euro.

znj. Kadrije Lika Troni: Lidhur me raportin financiar të inkasimit të te hyrave vetanake edhe herën e kaluar në mbledhjen e KPF-së e bëra pyetje dhe prapë po e përsërisë shembull te drejtoria e arsimit dhe drejtoria e kulturës pse nuk kemi një raport të detajuar, me qëllim që të shihet dhe të analizohet procesi i punës dhe hyrjes së mjeteve nga palestra sportive.

Sistemi i komunës a gjeneron raport te të hyrave të llojeve ne këtë drejtori dhe pse nuk janë paraqitur në tabelë të te hyrave vetanake më në detaje sikurse kategoritë tjera të drejtorive tjera.

z.Bahri Selimi: Buxheti fillestar aktual ka arritur 11,178,263.91 euro, mirëpo buxheti do të rritet ende pasi qe ministria ne fillim nuk na ka lejuar me i bartë të gjitha të hyrat por 320,000.00 euro mundemi me i bartë në vite.

Te tatimi në pronë kemi pasur debate të ndryshme rreth tatimeve mirëpo qytetarët kanë vendos që te paguajnë tatimin në pronë dhe tani ministria ka marr vendimin për 100 euro falje dhe në vitin e ardhshëm do ti rimbursohet secilit qytetarë vlere prej 100 euro.

Shpenzimet kapitale janë për të gjithë më shqetësuese dhe vetëm 15% janë realizuar, por në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar ku atëherë kemi shpenzuar vetëm 67,000.00 euro ndërsa në këtë vit kemi realizuar 491,000.00 euro, që d.m.th për 424,000.00 euro kemi shpenzuar më shumë mjete në këtë vit, nuk po themi qe kjo situatë është e mirë por krahasuar me periudhën e kaluar mund të themi që kemi avancuar.

Te mallrat dhe shërbimet 142,000.00 euro mirëmbajtja e rrugëve, rrugët lokale ku 20,000.00 euro kemi me pak se viti i kaluar. Kemi edhe të hyra indirekte mirëpo nuk janë të paraqitura në raport për shkak se auditori i jashtëm ka rekomanduar këtë pasi që planifikimi dhe realizimi nuk është rezultat i komunës ndërsa të drejtën me i shpenzua e kemi si komunë.

Te kultura do të mundohemi me pas të hyra të veçanta, megjithëse nuk është qe ka pas kurse te arsimit janë participimi veç një lloj i te hyrave.

z.Agim Mani: Te të hyrat indirekte drejtor, konkretisht tek inkasimi nga gjobat d.m.th. ju i keni llogarinë e juaja, mjetet i keni por unë po kërkojë ti bëni transparente d.m.th. me i deklarua edhe me shkrim se sa është realizimi nga kjo kategori.

z. Agim Çaka: Drejtor nuk e kuptova këtë punën që disa komuna që janë duke punuar, gjë që shihet në praktik d.m.th. punë që e shohin edhe vetë qytetarët se janë duke punuar ata kanë problem me ligjin, apo ne që nuk jemi duke punuar d.m.th. qe kemi shpenzuar mjete jemi tu

mundu me qenë brenda ligjit, sipas jush ligji po na thotë neve që më ngadalë me punua, se mirë keni shkua deri më tani, ju lutem merreni shembull rastin e komunës së Ferizaj-it sa ndërtimet i ka zhvillu, sa ndërhyrjet i ka bërë mbi hekurudhë dhe nën hekurudhë, e sa banesa 7,8 katesh.

Kryesuesi i Kuvendit: Në ata çka u përgjigj drejtori ne po e kuptojmë që është shqetësim niveli i ulët i shpenzimeve në investimet kapitale. Drejtori nuk tha që kanë punuar kundërligjshëm sepse dyshova që e keqkuptove drejtorin, por ai tha kanë pasur borxhe paraprake dhe një prej komunave që ka pas borxhe më së paku ka qenë komuna e Kaçanikut nga vitet fiskale të kaluara. Komunitet tjera që kanë qenë në borxhe, disa me përmbarues e disa me obligime që i kanë paguar, ju kanë marrë prej buxhetit dhe aty i figuron shpenzim por komuna jone nuk ka pas borxhe.

A është nivel i ulët i shpenzimeve kapitale është i ulët, por përderisa jemi në 6 (gjashtë) mujorin e parë të vitit, një pjesë e punëve janë kryer mirëpo përderisa sa është bërë raporti nuk janë alokuar mjetet, dhe nuk mundur te shpenzohen këto mjetet prandaj nuk kanë mundur te hyjnë ne raport dhe një pjesë e tyre janë përfundim e sipër dhe një pjesë e punëve janë të kontraktua dhe ne mund të flasim në fund vitit se ku jemi me shpenzimet e këtij viti, por pajtohem me ata që është dashtë me shkua pak më shpejt në këtë drejtim, por si do që të jetë mund të flasim edhe fund të vitit.

Ne asnjëherë nuk kemi hy ne mesin e komunave që ka pas suficitin në fund të vitit sikur komunitet e tjera, që po doni të bëni krahasime me komunitet e tjera që kanë shkua me 40 milion suficit, prandaj mos të bëjmë krahasime të flasim për vete ti trajtojmë problemet tona, ku jemi ne, të mundohemi me dhanë më të mirën e mundshme për qytetarët edhe për veten tonë, sepse nëse bëjmë krahasime ne gabojmë se nuk e dimë gjendjen si e kanë, kemi material me pa shohim por nuk e dimë qysh është gjendja, a është bërë me borxh apo me çka është bërë nuk e dimë kështu që ju lus të fokusohemi në materialet tona konkretisht në dokumentet tona që i kemi përpara dhe gjendjen faktike tonën.

z. Naim Beça: Shqetësimet e deputeteve, duhet të bëhen me shkrim sepse është pamundur të mbahen në kujtesë një numër kaq i madh i shifrave të ndryshme.

znj. Ardita Rrahmani : A janë shpenzimet kapitale për kritikë? PO janë!

Nuk desha te deklarojem mirëpo me nxiti vet fakti i krahasimeve ndërmjet komunave kur nga drejtori u potencua që mos u merrni me komunitet e mëdha por me komunitet përafërsisht sa ne, ose me buxhet sa ne! Drejtor hiq ma larg se komuna Hani i Elezit, të cilën pak kilometra e ndajnë nga ne, besojë po e shohim sa po punojmë, a është i duhur ky krahasim le të mbetet në vlerësimin e juaj?

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, Raporti financiar gjashtëmujor për periudhën Janar – Qershor 2023 kalon si informatë, kështu që konstatohet se Kuvendi i Komunës,

NJOFTOHET

Me Raportin gjashtëmujor financiar, Janar-Qershor 2023/ Lënda: 01Nr.400/01-17269/23.

3. Propozim Vendim për vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronë private, ZK Runjevë;

Kryesuesi i Kuvendit: Materialin e keni marrë, para se me hap diskutimin, fjalën e ka drejtori i DUKMM, Qamil Stagova:

z. Qamil Stagova : Në bazë këtij Propozim Vendimi një sipërfaqe e tokës prej 161.60 m², i jepet rrugës kurse rrugës i merret me një sipërfaqe 161.32 m², rruga drejtohet dhe i përmirësohet gjendja atyre qytetarëve që i kanë pronat aty po ashtu edhe dy qytetar tjerë të cilët kanë pronë por që nuk i prek direkt në pronat e tyre janë pajtuar me këtë ndryshim.

z.Agim Mani: Drejtor ju jeni marr me këtë propozim vendim edhe fizikisht keni qenë sigurisht edhe në vendin e ngjarjes. Tani ne po i shohim dhe jemi tu marr vetëm me letra d.m.th. me procedura, ky propozim vendim që na është sjell këtu në kuvend sot fillimisht ka filluar nga kërkesa e një qytetari, ku kërkesa e qytetareve ka qenë këmbimi i pronës ose zgjerimi i rrugës po flas në bazë kërkesës qytetareve, qytetari ka kërkuar në zyrën kadastrale në Kaçanik për lëshim të informacioneve, certifikatën e pronës, listën e koordinatave, kopjen e planit të parcelës 00471-0, ZK Runjevë. Sa i përket çështjes së qytetarëve, ata i kanë përfunduar procedurat e tyre me inxhinier me matje me të gjitha mirëpo ju si ekzekutiv nuk e keni kryer punën e juaj, nëse me të vërtetë doni me i krye punë qytetarit duhet të ia kompletoni dokumentacionet, po e marr shembull kërkesë e ka paraqitur parcelën 00471-0, parcela 00471-0,1, nuk figuron as në skicë po ashtu nuk posedon as fletë poseduese që është e komunës dhe nuk ka kurrfarë dëshmie që kjo parcelë është pronë publike qysh me marr na vendim për këtë parcelë kur nuk kemi njoftim për dokumentacion me në detaje, për atë nëse me vërtetë doni me përfundua këtë punë ka qenë dashtë me i kompletua dokumentacionet jo me lan ministrin me kthye prapë dhe mu arsyetua te qytetari që ne e kemi krye punën tonë por ministria e ka kthye në këtë rast po e nënkupton që me ua lëne fajin ministrisë.

z.Qamil Stagova : Mirëpo kësi lloje këmbimeve si këto vendime për këmbim nuk kemi pas problem asnjëherë me ministri.

z.Agim Mani : I kemi dy vendime që kanë me na ardhur me i shfuqizua, d.m.th. janë të njëjta janë gati mirëpo përveç fletës poseduese as në skicë nuk ekziston kjo parcelë 00471-0.

z.Rrustem Zenuni : Na qysh në fillim jemi deklaruar që këto lloje të propozimeve do ti mbështesim vazhdimisht.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka ,atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe i njëjti u aprovua me 12 për, abstenim 13 . Prezentë 25.Në saj të kësaj del konstatimi se Kuvendi i komunës mori këtë:

Vendim

Për vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private, ZK Runjevë / Lënda 06 Nr.350/01-17440/23.

4. Propozim Vendim për vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ,ZK Begracë;

Kryesuesi i Kuvendit: Fjalën ia kalojmë fillimisht drejtorit për sqarime, pastaj e hapim diskutimin:

z. Qamil Stagova : Parcela private ZK Begracë kalon pronësi të komunës kurse pjesa e ngasës kadastrale 2420-3 e cila është pjesë e rrugëve, mirëpo është një pjesë e cila veç nuk shkon vazhdimësi me rrugën me një sipërfaqe 69 m², kalon në pronë private.

z. Selajdin Troni : Desha ta pyes drejtorin, a ka ndonjë problem të rënd komuna që është duke i bërë këto prona, a ka ndonjë benefit apo veç për qytetarët, sepse nëse paraqitet ndonjë problem për ardhmen atëherë është adekuate ti rishikojmë mirë këto.

z.Qamil Stagova : Rasti i parë ajo rrugë drejtohet dhe është në të mirën e qytetarëve por edhe i komunës por këtu është me prioritet më shumë interesi i qytetarëve .

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka ,atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe i njëjti u aprovua me 13 për, abstenim 11, Raif Kasa ishte prezentë por nuk mori pjesë në votim . Prezentë 25.Në saj të kësaj del konstatimi se Kuvendi i komunës mori këtë:

Vendim

Për për vërtetimin e interesit të përgjithshëm publik për këmbim të pronës komunale me pronën private ,ZK Begracë / Lënda 06 Nr.350/01-17441/23.

5. Propozim Vendim për ndryshim plotësimin e Vendimit 01Nr.60/01-33331/22 ,të datës 29.12.2022 - Për ndryshim plotësimin e vendimit të kuvendit të komunës 01NR.104/02-19963 ,të datës 02.09.2022 - Për formimin e komisionit të ankesave për procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;

Kryesuesi i Kuvendit: E keni marrë materialin, është një ndryshim plotësim për të cilën kanë kërkuar me plotësua, është dorëheqja e anëtares nga komisioni Arbnora Kukës nëse ka diçka rreth kësaj urdhëroni dhe me duket se është me njëherë plotësimi me një anëtarë tjetër nga ekzekutivi është Kaltrina Çaka.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka ,atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe i njëjti u aprovua me 24 për, abstenim 1. Prezentë 25.Në saj të kësaj del konstatimi se Kuvendi i komunës mori këtë:

Vendim

Për ndryshim plotësimin e Vendimit 01Nr.60/01-33331/22 ,të datës 29.12.2022 - Për ndryshim plotësimin e vendimit të kuvendit të komunës 01NR.104/02-19963 ,të datës 02.09.2022 - Për formimin e komisionit të ankesave për procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës /Lënda 01Nr. 60/01-17846/23

6. Propozim Vendim për ndryshim plotësimin e Vendimit paraprak 01Nr.104/02-13790/23,të datës 30.06.2023 Për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër.

Kryesuesi i Kuvendit: Në kuadër të kësaj ju njoftova paraprakisht që Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuadër të kompetencave ligjore që ka dhe në kuadër që ne i kemi dërguar për shqyrtim të ligjshmërisë vendimet, kanë kërkuar që ai vendim të përshtatet apo të harmonizohet me ligjet në fuqi që janë dhe që kanë të bëjnë me dhënien e pronës komunale në shfrytëzim sepse në vendimin paraprak që kemi marrë në mbledhjen e kaluar kanë qenë të parapara dhënia e pronës në shfrytëzim afatgjatë dhe afatshkurtër dhe për këtë kontekst ministria ka kërkuar që ky vendim të përimtohet dhe të ndahen pronat që jepen me kohë afatgjatë dhe afatshkurtër, për arsye se janë dy procese të ndara. Në këtë rast zyrtarët kanë arritur që ta plotësojnë ndryshojnë vendimin të heqin pjesën e pronës që ka të bëjë me afatshkurtër dhe të lejnë në vendim paraprak vetëm pjesën e pronës që ka të bëjë dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës.

z. Selajdin Troni: A ka drejt komisioni për pronat me shfrytëzim afatgjatë me vazhdua punën?

Kryesuesi i Kuvendit: E kemi komisioni pas kësaj pike njëherë, se ato kanë kërkuar plotësim ndryshimin.

Rrustem Zenuni : Për mu vërtet është befasues qysh i ka ra mend ministrisë me të njëjtin ligj dhe me të njëjtin format edhe vitin e kaluar dhe vitet paraprake .

Kryesuesi i Kuvendit: Ministria ka vepruar shumë drejt ë kohë rekord me afat .

z. Agim Çaka: Arsyen që abstenova është kjo ligji për dhënien e pronave tregon sakte që për çdo pronë duhet me përcaktua a është afatmesme apo afatgjatë dhe çdo pronë kur ndahet duhet me pas komision të veçantë.

znj. Ernesta Krasniqi: Veç desha me i tregu z. Rustemit, që këtë ligj e kemi lexuar këtu dhe ju kemi njoftuar që vendimi paraparak është në kundërshtim me ligjin dhe kemi kërkuar që të mos e votoni sepse duhet me u nda për afatshkurtër dhe afatgjatë, por ju keni thënë se na kanë kaluar pronat, andaj kështu ju ndodh kur nuk e lexoni ligjin!

z. Agim Mani: Me të vërtetë ky propozim vendimi na ka ardhur me vonesë sot, unë nuk kam mundur as ta lexoj por vetëm ju dëgjova juve kryesues, megjithatë ne nuk duhet të bazohemi në fjalët e juaja. E përsëris që ne nuk kemi pas kohë me lexua dhe tani nëse ky propozim nuk analizohet por bazohemi vetëm në fjalë mund të gabojmë ashtu siç kemi gabuar në të kaluarën, prandaj unë kërkoj që kjo pikë të shtyhet për mbledhjen e ardhshme me qëllim që të kemi kohe me shumë për ta analizuar sepse nuk bën te votojmë diçka që nuk e dimë.

Kryesuesi i Kuvendit: Tek çështja e Agimit që e ngriti shkurte edhe koha. pajtohem me atë plotësisht edhe na e kemi pas shumë shkurt kohën për me punua si propozim vendim, zyrtaret sot e kanë punuar me arsyetim për arsye se ne jemi në muajin gusht dhe jemi në pushim dhe në fund të muajit shtatorit jemi në mbledhje, mund të pengohet një proces që ka me sjell përfundim dhe për këtë arsye e kemi bërë kështu. Për me kuptua këtë propozim vendim nuk është e vështirë sepse ministria e ka thënë shumë qartë, i keni 3 -4 rreshta arsyetimin e ministrisë se çka ka kërkuar. Ministria ka vepruar shumë drejtë për mendimin tim, dikush mundet me pas mendim tjetër që nuk ka vepruar drejt por edhe nëse nuk vepron drejtë ne jemi të obliguar me zbatua vendimet e ministrisë që na i sjell sepse është ligj, kështu që nëse është ndonjëri që është mbi ligjin atëherë unë nuk e di, unë personalisht nuk jam. Ne duhet ta zbatojmë Vendimin e ministrisë gjithashtu duhet me harmonizua propozim vendimin tonë me udhëzimet që na ka dhënë ministria, andaj mendoj që kemi vepruar në atë formë për me kuptua nuk është vështirë Agim sepse janë 3-4 rreshta arsyetim edhe është propozim vendimi që është harmonizua me qeto 3-4 rreshta, kështu që kjo është ajo që ne jemi thirr këtu dhe është bërë për arsye se ne muajin gusht jemi në pushime ndërsa afati ligjor i rishqyrtimit të këtij vendimi skadon është 30 ditë. Ne nuk kemi mbledhje është 30 ditë, për mos me thirr një mbledhje të jashtëzakonshme juve me ju mundu edhe ne muajin gusht pastaj që ta rishqyrtojmë këtë vendim se jemi brenda afatit ligjor kemi menduar që në këtë mbledhje mund ta rishqyrtojmë sepse nuk është diçka që nuk kuptohet dhe nuk kalohet kjo ka qenë arsyeja.

z. Agim Mani : Këtë që e thash ma herët d.m.th. nuk jam tu thane sot, se sot për sot me të vërtetë është vonë por këtë e kemi thënë vazhdimësi qysh kur i keni sjell listat në kuvend na i keni kërkuar, ne jemi kanë të qartë sa i përket dhënies së pronave në shfrytëzim, qysh kur i keni sjell listat keni kërkuar të caktohet afati dhe përsëri i keni sjell në kuvend me gabime, me afate të përbashkëta. Ne kemi qenë kundër prapë d.m.th. ne kemi qenë parimor sa i përket bazës ligjore, të bazuar në ligj për këtë që të kryhen procedurat paraprakisht dhe jo të vijnë në këtë formë sepse nëse nuk i lexojmë dhe nëse nuk i shqyrtojmë mirë na sjellin problemin tjetër, për këtë shkak kërkoj kohë, andaj mundesh edhe me thirr mbledhje të jashtëzakonshme qoftë edhe për një pikë dhe më mirë është me thirr mbledhje të jashtëzakonshme me u konsultua mirë për faktin që mos të marrim ndonjë vendim te ngutshëm dhe te biem ndesh me ligjin.

Kryesuesi i Kuvendit: A ka mundësi të sqaroni se ku po biem ndesh me ligjin këtu?

z. Agim Mani : Unë nuk e kam lexuar!

Kryesuesi i Kuvendit: Është e drejta e juaja a lexoni apo jo, por kur po potenconi që jemi ndesh me ligjin, kjo është vetëm kërkesë dhe mendimi i juaj, pra ne të gjithë jemi këtu dhe gjithsecili mund të jep mendimin për vete. Unë thash meqë është në plan të punës së kuvendit dhe anëtarët e kuvendit kanë mund të përgatiten për pushime sepse muaji gusht është muaji i pushimit prandaj me qëllim që të mos të na tejkaloj afati ligjor i shqyrtimit të këtij vendimi, e

kemi sjell sot me procedurë të shpejt. Ky vendim tek unë ka ardhur në ditën e premte dhe shumë vonë dhe besojë që edhe tek kryetari ka ardhur në këtë kohë. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit ka afat 30 ditë, por ne jemi në pushim në muajin gusht dhe besojë që e kemi të qartë që kjo është arsyeja pse ka ardhur kaq shpejt.

z. Adnan Reka: Cila është urgjenca që duhet patjetër mos me lan për në mbledhjen tjetër, pse duhet kaq shpejt të merret ky vendim?

Kryesuesi i Kuvendit: Urgjenca e kësaj çështje është sepse muaji gusht është pushim, në muajin shtator është në fund mbledhja, në muajin tetor bëhet shqyrtimi i ligjshmërisë së vendimeve, është procedura e ankandit publik d.m.th. këtë vit kjo procedurë ngecet, tani a jemi ne për të krijuar kushte dhe mundësi për njerëz që janë të interesuar me investua apo jemi për me i shty ma shumë kjo është arsyeja!

z. Adnan Reka: Ne jemi për të krijuar kushte dhe mundësi përmes ligjit në kushte të rregullta dhe në baza ligjore, jo me u ngut e me ndërmarrë hapa të gabuar ashtu si kemi vepruar deri më tani, prandaj ne po themi mos u ngutni, ma mirë me ja krijua kushtet tamam si duhet, se sa pas disave me shkua në gjykata.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse ne nuk jemi në rregull, ata prapë i kthejnë te ne dhe mbetet për muajin shtator.

z. Adnan Reka: Dy vendimet e mbledhjes paraprake na nuk i shqyrtuam, ato shkojnë në gjykatë sepse i anuluan.

Kryesuesi i Kuvendit: Nuk kanë kërkuar të anulohen por kanë kërkuar informata shtesë përgjegjëseve për atë punë. Adnan ju jeni në njohuri që në atë vendim janë kërkuar informacione shtesë nga Drejtoria e Urbanizmit. Ne e kemi sjell vendimin këtu në kuvend dhe drejtori këtu në kuvend potencoi që ne i kemi dërguar ato informacione, mirëpo vendimi ka ardhur para se me i dërgua informacionet, prandaj tash po e presim përgjigjen e tyre.

z. Adnan Reka : Për këtë unë ju pyeta a janë dërguar informacionet shtesë dhe a keni pranuar një vendim qe gjithçka është në rregull?

z. Qamil Stagova: Jo ende nuk ka ardhur asnjë vendim për këtë!

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka ,atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe i njëjti u aprovua me 13 për, kundër 5, abstenim 7. Prezentë 25.Në saj të kësaj del konstatimi se Kuvendi i komunës mori këtë:

Vendim

Për ndryshim plotësimin e Vendimit 01Nr.60/01-33331/22 ,të datës 29.12.2022 -Për ndryshim plotësimin e Vendimit të kuvendit të komunës 01NR.104/02-19963 ,të datës 02.09.2022- Për formimin e komisionit të ankesave për procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës / Lënda 01Nr.104/02-18514/23.

7. Propozim Vendim për ndryshim plotësimin e Vendimit 01Nr.104/02-13788/23, të datës 30.06.2023 Për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;

Kemajl Murseli: Në kërkesën e ministrisë është cekur që për secilin vendim paraprak duhet jete komision i veçantë, specifikisht për pronat me shfrytëzim afatgjatë të formohet një komision i veçantë dhe për pronat me shfrytëzim afatshkurtër të formohet komision i veçantë. Në këtë rast me plotësim ndryshimin që e kemi bërë, mbetet komisioni që ka qenë ekzistues

nëse nuk ka ndonjë ndërhyrje nga subjektet që kanë propozuar anëtarë në komision, d.m.th. edhe ekzekutivi edhe shoqëria civile i ka lënë të njëjtit anëtarë, andaj nga subjektet e tjera kërkoj që nëse ka ndonjë ndërhyrje për me i ndryshua anëtarët e komisionit, nëse jo atëherë ky komision mbetet. Këtij komisioni i hiqet pika ku është cekur norma e pagesës për anëtarët e komisionit, po ashtu është kërkuar që të shikohet Ligji i Financave dhe të harmonizohet çështja e pagesave dhe po supozoj që kanë pasur qëllimin që nuk kem mundësi me i pagua. Ky komision ka të bëjë vetëm me pronat në dhënien me shfrytëzim afatgjatë pa ato me afatshkurtër që kanë qenë në një vendim përbashkët.

z. Adnan Reka: A ka mundësi që këto dy propozim vendime edhe vendimin e shfuqizimit të na i dërgoni në formë elektronike.

Kryesuesi i Kuvendit: Vendimet i keni edhe në kopje fizike por do të ju përcjellim edhe përmes postës elektronike.

z. Betim Shala: Këtu po thotë le të harmonizohet kjo çështje e pagesës së komisioneve. Ne mund ta bëjmë plotësim ndryshimin e rregullores për taksat dhe tarifat, madje aty e shtijë pagesën e këtij komisioni apo secilit komision të cilin duhet me pagua, nëse ky vendim nuk kalon me pagesë atëherë e shtim të rregullorja e tjetër dhe nuk mundën me refuzua sepse e ka Ministria Financave.

Kryesuesi i Kuvendit: Te rregullorja e taksave dhe tarifave nuk mundën me shti sepse ajo rregullore trajton krejt diçka tjetër, por ne mund ta bëjmë një rregullore të veçantë për pagesat e komisioneve por a na lejon apo nuk na lejon, por edhe si pike dhe si vendim nuk na kanë lejuar, këtu thotë se harmonizohu me rregulloren në fuqi, mirëpo drejtori thotë se me rregulloren në fuqi nuk lejohet pagesa.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime tjera nuk ka, atëherë e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe i njëjti u aprovua me 13 për, kundër 5, abstenim 7. Prezentë 25. Në saj të kësaj del konstatimi se Kuvendi i komunës mori këtë:

Vendim

Vendim për ndryshim plotësimin e Vendimit 01NR.104/02-13788/23 të datës 30.06.2023 për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës / Lënda 01Nr.104/02-18517/23

Mbledhja i përfundoj punimet në ora 14:30. Deri në fund të mbledhjes ishin 25 anëtarë. Ndërkaq me leje të Kryesuesit të KK, dolën me herët: Hamide Luma, Arta Avdiu

Procesmbajtëse
Mavije Murseli

Kryesues i Kuvendit
Kemal Murseli



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01–Nr. 100/03-24374 /23
Kaçanik; 15.09.2023

Në mbështetje të nenit 24 dhe 40.2(b) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 61. të Ligjit nr.03/L-048. – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, nenit 2 të Ligjit nr.03/L-049 – Për Financat e Pushtetit Lokal, Qarkores Buxhetore MFPT 2024/02 dhe nenit 73 të Statutit të Komunës, Kryetari i Komunës propozon:

P r o p o z o n

Që Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e radhës që zhvillohet në muajin shtatorë 2023, të shqyrton dhe aprovon këtë:

V E N D I M

PËR BUXHETIN E KOMUNËS SË KAÇANIKUT PËR VITIN FISKAL 2024 DHE VLERËSIMET PËR VITET 2025 - 2026

I

Buxheti total i Komunës së Kaçanikut për vitin buxhetor 2024 është në shumë prej 11,958,983.00€, ndërsa për vitin 2025 vlerësimet e projektuara janë në masë monetare prej 12,579,771.28€ dhe për vitin 2026 në shumë prej 13,195,938.00€.

II

Në strukturën e të hyrave të tërësishme buxhetore për vitin buxhetor 2024, sipas pikes I. të këtij vendimi, mjetet nga Grantet qeveritare janë në shumë prej 11,034,783.00€, që shënojnë pjesmarrje me 92% dhe të Hyrat Vetanake Komunale, në shumë prej 924,200.00€, me një pjesmarrje prej 8% në strukturën e përgjithshme të Buxhetit.

III

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore për vitin buxhetor 2024, parashikohen të jenë për Shpenzime Operative shuma prej 8,796,222.00€ dhe për Investime Kapitale, shuma prej 3,162,761.00€.

IV.

Shpenzimet buxhetore për vitin 2024, sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve, parashikohet të kenë këto ndarje e të cilat janë në përputhje të plotë me Qarkoren Buxhetore 2024/02 të Ministrisë së Financave Punës dhe Transfereve (MFPT):

- Shpenzimet për Paga dhe Mëditje	6,759,180.00 €
- Shpenzimet e Mallrave dhe Shërbimeve	1,421,513.00 €
- Shpenzimet e Shërbimeve Komunale	200,000.00 €
- Subvencionet dhe Transferet	415,529.00 €
- Shpenzimet në Investime Kapitale	3,162,761.00 €

V

Për zbatimin e këtij vendimi për Buxhetin e Komunës, obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

VI

Ky vendim hyn në fuqi nga dita e aprovimit dhe do të vlejë për deri sa nuk merret ndonjë vendim tjetër.

Besim ILAZI,
Krytar i Komunës

The stamp is circular with a double border. The outer border contains the text "REPUBLIKA E KOSOVës" at the top and "OPŠTINA KAČANIK" at the bottom, separated by stars. The inner circle features a shield with a map of Kosovo and the text "KOMUNA E KAČANIK" above it. A signature in blue ink is written across the stamp.

Tabela 4.1. - Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2024

Komuna	Kod.I programi/nenprogrami	Program	Nën-program	Përshkrimi	Stafi 2024	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzime komunale	Subvencione dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Totali
a	b	c	d	e	f	g	h	i	j	k	l
Kaçanik - 652				TOTAL SHPENZIMET	806	6,759,180	1,421,513	200,000	415,529	3,162,761	11,958,983
				Grantet Qeveritare	806	6,749,180	1,332,013	155,000	314,142	2,484,448	11,034,783
				Të hyrat vetanake	-	10,000	89,500	45,000	101,387	678,313	924,200
				Huamarrja	-	-	-	-	-	-	-
1	160	Zyra e Kryetarit			26	242,734	30,000	-	70,529	-	343,263
				Grantet Qeveritare	26	242,734	30,000	-	50,529	-	323,263
				Të hyrat vetanake	-	-	-	-	20,000	-	20,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
1.1.	16028	Zyra e Kryetarit			26	242,734	30,000	-	70,529	-	343,263
				Grantet Qeveritare	26	242,734	30,000	-	50,529	-	323,263
				Të hyrat vetanake	-	-	-	-	20,000	-	20,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
2	169	Zyra e Kuvendit Komunal			-	221,755	5,000	-	-	-	226,755
				Grantet Qeveritare	-	221,755	-	-	-	-	221,755
				Të hyrat vetanake	-	-	5,000	-	-	-	5,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
3	163	Administrata dhe personeli			25	156,966	94,000	15,000	-	337,000	602,966
				Grantet Qeveritare	25	156,966	82,000	10,000	-	330,000	578,966
				Të hyrat vetanake	-	-	12,000	5,000	-	7,000	24,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
3.1.	16328	Administrata			24	146,718	92,000	15,000	-	337,000	590,718
				Grantet Qeveritare	24	146,718	82,000	10,000	-	330,000	568,718
				Të hyrat vetanake	-	-	10,000	5,000	-	7,000	22,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
3.2	16528	Qështje Gjimore			1	10,248	2,000	-	-	-	12,248
				Grantet Qeveritare	1	10,248	-	-	-	-	10,248
				Të hyrat vetanake	-	-	2,000	-	-	-	2,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
4	175	Buxheti dhe financat			11	79,304	10,000	-	-	165,000	254,304
				Grantet Qeveritare	11	79,304	5,000	-	-	35,000	119,304
				Të hyrat vetanake	-	-	5,000	-	-	130,000	135,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
4.1.	17528	Buxhetimi			11	79,304	10,000	-	-	165,000	254,304
				Grantet Qeveritare	11	79,304	5,000	-	-	35,000	119,304
				Të hyrat vetanake	-	-	5,000	-	-	130,000	135,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
5	180	Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjencia			29	245,601	325,000	82,000	60,000	614,313	1,326,914
				Grantet Qeveritare	29	245,601	320,000	72,000	39,878	455,000	1,132,479
				Të hyrat vetanake	-	-	5,000	10,000	20,122	159,313	194,435
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
5.1.	18028	Infrastruktura rrugore			11	113,823	315,000	80,000	60,000	614,313	1,183,136
				Grantet Qeveritare	11	113,823	315,000	70,000	39,878	455,000	993,701
				Të hyrat vetanake	-	-	-	10,000	20,122	159,313	189,435
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
5.2.	18432	Zjarrfikësit dhe inspektimet			18	131,777	10,000	2,000	-	-	143,777
				Grantet Qeveritare	18	131,777	5,000	2,000	-	-	138,777
				Të hyrat vetanake	-	-	5,000	-	-	-	5,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
6	195	Zyra e Komuniteteve			1	10,440	1,000	-	-	-	11,440
				Grantet Qeveritare	1	10,440	-	-	-	-	10,440
				Të hyrat vetanake	-	-	1,000	-	-	-	1,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
7	470	Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi rural			15	104,112	13,000	-	100,000	50,000	267,112
				Grantet Qeveritare	15	104,112	11,000	-	78,735	50,000	243,847
				Të hyrat vetanake	-	-	2,000	-	21,265	-	23,265
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
7.1.	47028	Bujqësia			4	44,962	3,000	-	100,000	50,000	197,962

			Grantet Qeveritare	4	44,962	3,000	-	78,735	50,000	176,697
			Të hyrat vetanake	-	-	-	-	21,265	-	21,265
			Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
7.2.	47108		Pylltaria dhe inspeksioni	11	59,150	10,000	-	-	-	69,150
			Grantet Qeveritare	11	59,150	8,000	-	-	-	67,150
			Të hyrat vetanake	-	-	2,000	-	-	-	2,000
			Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
8	480		Zhvillimi Ekonomik	3	23,954	5,000	-	40,000	335,000	403,954
			Grantet Qeveritare	3	23,954	-	-	10,000	270,000	303,954
			Të hyrat vetanake	-	-	5,000	-	30,000	65,000	100,000
			Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
8.1	48028		Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik	3	23,954	5,000	-	40,000	335,000	403,954
			Grantet Qeveritare	3	23,954	-	-	10,000	270,000	303,954
			Të hyrat vetanake	-	-	5,000	-	30,000	65,000	100,000
			Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
9	660		Planifikimi urban dhe mjedisi	13	116,207	62,500	-	-	804,448	983,155
			Grantet Qeveritare	13	116,207	47,500	-	-	654,448	818,155
			Të hyrat vetanake	-	-	15,000	-	-	150,000	165,000
			Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
9.1.	66445		Planifikimi urban dhe inspeksioni	13	116,207	62,500	-	-	804,448	983,155
			Grantet Qeveritare	13	116,207	47,500	-	-	654,448	818,155
			Të hyrat vetanake	-	-	15,000	-	-	150,000	165,000
			Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
10	730		Shëndetësia dhe Mirëq.Sociale	122	1,166,947	202,513	30,000	-	160,000	1,559,460
			Grantet Qeveritare	122	1,166,947	185,513	25,000	-	160,000	1,537,460
			Të hyrat vetanake	-	-	17,000	5,000	-	-	22,000
			Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
10.1	73037		Administrata	3	28,651	2,000	-	-	-	30,651
			Grantet Qeveritare	3	28,651	-	-	-	-	28,651
			Të hyrat vetanake	-	-	2,000	-	-	-	2,000
			Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
10.2	74700		Shërbimet e shëndetësisë primare	119	1,138,296	200,513	30,000	-	160,000	1,528,809
			Grantet Qeveritare	119	1,138,296	185,513	25,000	-	160,000	1,508,809
			Të hyrat vetanake	-	-	15,000	5,000	-	-	20,000
			Huamarrja	-	-	-	-	-	-	-
11	75635		Shërbimet sociale	8	53,545	3,000	5,000	10,000	1,500	73,045
			Grantet Qeveritare	8	53,545	3,000	3,000	10,000	-	69,545
			Të hyrat vetanake	-	-	-	2,000	-	1,500	3,500
			Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
12	850		Kulturë, Rini dhe Sport	18	131,629	130,000	18,000	85,000	135,000	499,629
			Grantet Qeveritare	18	131,629	130,000	13,000	85,000	80,000	439,629
			Të hyrat vetanake	-	-	-	5,000	-	55,000	60,000
			Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
12.1	85028		Shërbime Kulturore	18	131,629	130,000	18,000	85,000	135,000	499,629
			Grantet Qeveritare	18	131,629	130,000	13,000	85,000	80,000	439,629
			Të hyrat vetanake	-	-	-	5,000	-	55,000	60,000
			Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
13	920		Arsimi dhe shkenca	535	4,205,986	540,500	50,000	50,000	560,500	5,406,986
			Grantet Qeveritare	535	4,195,986	518,000	32,000	40,000	450,000	5,235,986
			Të hyrat vetanake	-	10,000	22,500	18,000	10,000	110,500	171,000
			Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
13.1	92140		Administrata	6	49,848	5,000	-	50,000	-	104,848
			Grantet Qeveritare	6	49,848	2,500	-	40,000	-	92,348
			Të hyrat vetanake	-	-	2,500	-	10,000	-	12,500
			Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
13.2	92750		Arsimi parashkollor dhe qerdhet	21	167,161	60,000	10,000	-	10,000	247,161
			Grantet Qeveritare	21	167,161	40,000	5,000	-	-	212,161
			Të hyrat vetanake	-	-	20,000	5,000	-	10,000	35,000
			Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
13.3	93810		Arsimi filior	406	3,127,435	355,500	30,000	-	400,500	3,913,435
			Grantet Qeveritare	406	3,127,435	355,500	20,000	-	350,000	3,852,935
			Të hyrat vetanake	-	-	-	10,000	-	50,500	60,500
			Huamarrja	-	-	-	-	-	-	-
13.4	95010		Arsimi i mesëm	102	861,541	120,000	10,000	-	150,000	1,141,541
			Grantet Qeveritare	102	851,541	120,000	7,000	-	100,000	1,078,541
			Të hyrat vetanake	-	10,000	-	3,000	-	50,000	63,000
			Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-

Tabela 4.1. - Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2025

Komuna	Kod i programit/ndarjes	Program	Nën-program	Përshkrimi	Stafi 2025	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencione dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Totali
a	b	c	d	e	f	g	h	i	j	k	l
Kaçanik - 652				TOTAL SHPENZIMET	806	6,779,457	1,439,993	214,600	452,927	3,692,795	12,579,772
				Grantet Qeveritare	806	6,769,457	1,351,993	170,100	372,927	2,958,249	11,622,726
				Të hyrat vetanake	-	10,000	88,000	44,500	80,000	734,546	957,046
				Huamarrja	-	-	-	-	-	-	-
1	160	Zyra e Kryetarit			26	242,733	35,000	-	70,000	-	347,733
				Grantet Qeveritare	26	242,733	25,000	-	40,000	-	307,733
				Të hyrat vetanake	-	-	10,000	-	30,000	-	40,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
1.1.	16028	Zyra e Kryetarit			26	242,733	35,000	-	70,000	-	347,733
				Grantet Qeveritare	26	242,733	25,000	-	40,000	-	307,733
				Të hyrat vetanake	-	-	10,000	-	30,000	-	40,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
2	169	Zyra e Kuvendit Komunal			-	221,755	15,000	-	-	-	236,755
				Grantet Qeveritare	-	221,755	5,000	-	-	-	226,755
				Të hyrat vetanake	-	-	10,000	-	-	-	10,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
3	163	Administrata dhe personeli			25	156,966	87,000	15,000	-	107,001	365,967
				Grantet Qeveritare	25	156,966	70,000	15,000	-	100,000	341,966
				Të hyrat vetanake	-	-	17,000	-	-	7,001	24,001
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
3.1.	16328	Administrata			24	146,718	85,000	15,000	-	107,001	353,719
				Grantet Qeveritare	24	146,718	70,000	15,000	-	100,000	331,718
				Të hyrat vetanake	-	-	15,000	-	-	7,001	22,001
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
3.2	16528	Qështje Gjimore			1	10,248	2,000	-	-	-	12,248
				Grantet Qeveritare	1	10,248	-	-	-	-	10,248
				Të hyrat vetanake	-	-	2,000	-	-	-	2,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
4	175	Buxheti dhe financat			11	73,274	10,000	-	-	350,000	433,274
				Grantet Qeveritare	11	73,274	5,000	-	-	150,000	228,274
				Të hyrat vetanake	-	-	5,000	-	-	200,000	205,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
4.1.	17528	Buxheti			11	73,274	10,000	-	-	350,000	433,274
				Grantet Qeveritare	11	73,274	5,000	-	-	150,000	228,274
				Të hyrat vetanake	-	-	5,000	-	-	200,000	205,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
5	180	Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca			29	245,600	305,000	79,600	60,000	674,999	1,365,199
				Grantet Qeveritare	29	245,600	305,000	79,600	60,000	393,954	1,084,154
				Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-	281,045	281,045
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
5.1.	18028	Infrastruktura rrugore			11	113,823	300,000	77,600	60,000	674,999	1,226,422
				Grantet Qeveritare	11	113,823	300,000	77,600	60,000	393,954	945,377
				Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-	281,045	281,045
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
5.2.	18432	Zjarrfikësit dhe inspektimet			18	131,777	5,000	2,000	-	-	138,777
				Grantet Qeveritare	18	131,777	5,000	2,000	-	-	138,777
				Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-	-
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
6	195	Zyra e Komuniteteve			1	8,463	1,000	-	-	-	9,463
				Grantet Qeveritare	1	8,463	-	-	-	-	8,463
				Të hyrat vetanake	-	-	1,000	-	-	-	1,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
7	470	Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi rural			15	104,112	20,000	-	100,000	60,000	284,112
				Grantet Qeveritare	15	104,112	10,000	-	80,000	60,000	254,112
				Të hyrat vetanake	-	-	10,000	-	20,000	-	30,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
7.1.	47028	Bujqësia			4	44,962	10,000	-	100,000	60,000	214,962
				Grantet Qeveritare	4	44,962	5,000	-	80,000	60,000	189,962
				Të hyrat vetanake	-	-	5,000	-	20,000	-	25,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
7.2.	47108	Pylltaria dhe inspeksioni			11	59,150	10,000	-	-	-	69,150
				Grantet Qeveritare	11	59,150	5,000	-	-	-	64,150
				Të hyrat vetanake	-	-	5,000	-	-	-	5,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-

8	480	Zhvillimi Ekonomik	3	23,954	5,000	-	50,297	150,000	229,251
		Grantet Qeveritare	3	23,954	5,000	-	30,297	100,000	159,251
		Të hyrat vetanake	-	-	-	-	20,000	50,000	70,000
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
8.1	48028	Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik	3	23,954	5,000	-	50,297	150,000	229,251
		Grantet Qeveritare	3	23,954	5,000	-	30,297	100,000	159,251
		Të hyrat vetanake	-	-	-	-	20,000	50,000	70,000
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
9	660	Planifikimi urban dhe mjedisi	13	116,207	43,015	-	-	1,310,795	1,470,017
		Grantet Qeveritare	13	116,207	43,015	-	-	1,189,295	1,348,517
		Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-	121,500	121,500
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
9.1	66445	Planifikimi urban dhe inspeksioni	13	116,207	43,015	-	-	1,310,795	1,470,017
		Grantet Qeveritare	13	116,207	43,015	-	-	1,189,295	1,348,517
		Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-	121,500	121,500
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
10	730	Shëndetësia dhe Mirëq.Sociale	122	1,196,922	360,978	50,000	-	50,000	1,657,900
		Grantet Qeveritare	122	1,196,922	350,978	20,000	-	50,000	1,617,900
		Të hyrat vetanake	-	-	10,000	30,000	-	-	40,000
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
10.1	73037	Administrata	3	28,651	5,000	-	-	-	33,651
		Grantet Qeveritare	3	28,651	5,000	-	-	-	33,651
		Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-	-
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
10.2	74700	Shërbimet e shëndetësisë primare	119	1,168,271	355,978	50,000	-	50,000	1,624,249
		Grantet Qeveritare	119	1,168,271	345,978	20,000	-	50,000	1,584,249
		Të hyrat vetanake	-	-	10,000	30,000	-	-	40,000
		Huamarrja	-	-	-	-	-	-	-
11	76635	Shërbimet sociale	8	50,972	5,000	2,000	10,000	5,000	72,972
		Grantet Qeveritare	8	50,972	5,000	2,000	10,000	-	67,972
		Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-	5,000	5,000
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
12	850	Kulturë, Rini dhe Sport	18	131,629	95,000	8,000	102,630	85,000	422,259
		Grantet Qeveritare	18	131,629	90,000	8,000	102,630	65,000	397,259
		Të hyrat vetanake	-	-	5,000	-	-	20,000	25,000
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
12.1	85028	Shërbime Kulturore	18	131,629	95,000	8,000	102,630	85,000	422,259
		Grantet Qeveritare	18	131,629	90,000	8,000	102,630	65,000	397,259
		Të hyrat vetanake	-	-	5,000	-	-	20,000	25,000
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
13	920	Arsimi dhe shkenca	535	4,206,870	458,000	60,000	60,000	900,000	5,684,870
		Grantet Qeveritare	535	4,196,870	438,000	45,500	50,000	850,000	5,580,370
		Të hyrat vetanake	-	10,000	20,000	14,500	10,000	50,000	104,500
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
13.1	92140	Administrata	6	49,848	8,000	-	60,000	-	117,848
		Grantet Qeveritare	6	49,848	8,000	-	50,000	-	107,848
		Të hyrat vetanake	-	-	-	-	10,000	-	10,000
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
13.2	92750	Arsimi parashkollor dhe qerdhet	21	167,161	100,000	10,000	-	-	277,161
		Grantet Qeveritare	21	167,161	80,000	8,500	-	-	255,661
		Të hyrat vetanake	-	-	20,000	1,500	-	-	21,500
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
13.3	93810	Arsimi filior	406	3,127,435	250,000	40,000	-	800,000	4,217,435
		Grantet Qeveritare	406	3,127,435	250,000	30,000	-	750,000	4,157,435
		Të hyrat vetanake	-	-	-	10,000	-	50,000	60,000
		Huamarrja	-	-	-	-	-	-	-
13.4	95010	Arsimi i mesëm	102	862,426	100,000	10,000	-	100,000	1,072,426
		Grantet Qeveritare	102	852,426	100,000	7,000	-	100,000	1,059,426
		Të hyrat vetanake	-	10,000	-	3,000	-	-	13,000
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-

Tabela 4.1. - Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të komunës për vitin 2026

Komuna	Kod i programit/ne nprogramit	Program	Nën-program	Përshkrimi	Stafi 2026	Pagat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencione dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Totali
a	b	c	d	e	f	g	h	i	j	k	l
Kaçanik - 652				TOTAL SHPENZIMET	806	6,799,795	1,478,872	228,549	480,102	4,208,620	13,195,938
				Grantet Qeveritare	806	6,799,795	1,407,872	215,000	170,102	3,602,639	12,195,408
				Të hyrat vetanake	-	-	71,000	13,549	310,000	605,981	1,000,530
				Huamarrja	-	-	-	-	-	-	-
1	160	Zyra e Kryetarit			26	248,683	20,000	-	80,102	-	348,785
				Grantet Qeveritare	26	248,683	20,000	-	60,102	-	328,785
				Të hyrat vetanake	-	-	-	-	20,000	-	20,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
1.1.	16028	Zyra e Kryetarit			26	248,683	20,000	-	80,102	-	348,785
				Grantet Qeveritare	26	248,683	20,000	-	60,102	-	328,785
				Të hyrat vetanake	-	-	-	-	20,000	-	20,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
2	169	Zyra e Kuvendit Komunal			-	220,145	5,000	-	-	-	225,145
				Grantet Qeveritare	-	220,145	-	-	-	-	220,145
				Të hyrat vetanake	-	-	5,000	-	-	-	5,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
3	163	Administrata dhe personeli			25	161,056	70,000	10,000	-	202,000	443,056
				Grantet Qeveritare	25	161,056	50,000	10,000	-	192,000	413,056
				Të hyrat vetanake	-	-	20,000	-	-	10,000	30,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
3.1.	16328	Administrata			24	149,856	65,000	10,000	-	202,000	426,856
				Grantet Qeveritare	24	149,856	50,000	10,000	-	192,000	401,856
				Të hyrat vetanake	-	-	15,000	-	-	10,000	25,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
3.2.	16528	Qësjtje Gjimore			1	11,200	5,000	-	-	-	16,200
				Grantet Qeveritare	1	11,200	-	-	-	-	11,200
				Të hyrat vetanake	-	-	5,000	-	-	-	5,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
4	175	Buxheti dhe financat			11	79,560	10,000	-	-	350,000	439,560
				Grantet Qeveritare	11	79,560	5,000	-	-	300,000	384,560
				Të hyrat vetanake	-	-	5,000	-	-	50,000	55,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
4.1.	17528	Buxhetimi			11	79,560	10,000	-	-	350,000	439,560
				Grantet Qeveritare	11	79,560	5,000	-	-	300,000	384,560
				Të hyrat vetanake	-	-	5,000	-	-	50,000	55,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
5	180	Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjenca			29	257,819	254,585	62,000	70,000	1,140,000	1,774,404
				Grantet Qeveritare	29	257,819	254,585	52,000	50,000	955,000	1,569,404
				Të hyrat vetanake	-	-	-	-	20,000	185,000	205,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
5.1.	18028	Infrastruktura rrugore			11	118,856	249,585	50,000	70,000	1,140,000	1,628,441
				Grantet Qeveritare	11	118,856	249,585	50,000	50,000	955,000	1,423,441
				Të hyrat vetanake	-	-	-	-	20,000	185,000	205,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
5.2.	18432	Zjarrfikësit dhe inspektimet			18	138,963	5,000	2,000	-	-	145,963
				Grantet Qeveritare	18	138,963	5,000	2,000	-	-	145,963
				Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-	-
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
6	195	Zyra e Komuniteteve			1	8,319	1,000	-	-	-	9,319
				Grantet Qeveritare	1	8,319	-	-	-	-	8,319
				Të hyrat vetanake	-	-	1,000	-	-	-	1,000
				Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-

7	470	Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi rural	15	106,739	20,000	-	100,000	80,000	276,739
		Grantet Qeveritare	15	106,739	15,000	-	-	50,000	171,739
		Të hyrat vetanake	-	-	5,000	-	100,000	-	105,000
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
7.1.	47028	Bujqësia	4	45,239	10,000	-	100,000	50,000	205,239
		Grantet Qeveritare	4	45,239	5,000	-	-	50,000	100,239
		Të hyrat vetanake	-	-	5,000	-	100,000	-	105,000
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
7.2.	47108	Pylltaria dhe inspeksioni	11	61,500	10,000	-	-	-	71,500
		Grantet Qeveritare	11	61,500	10,000	-	-	-	71,500
		Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-	-
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
8	480	Zhvillimi Ekonomik	3	24,300	15,000	-	60,000	200,000	299,300
		Grantet Qeveritare	3	24,300	15,000	-	30,000	100,000	169,300
		Të hyrat vetanake	-	-	-	-	30,000	100,000	130,000
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
8.1	48028	Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik	3	24,300	15,000	-	60,000	200,000	299,300
		Grantet Qeveritare	3	24,300	15,000	-	30,000	100,000	169,300
		Të hyrat vetanake	-	-	-	-	30,000	100,000	130,000
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
9	660	Planifikimi urban dhe mjedial	13	113,580	150,000	-	-	1,581,619	1,845,199
		Grantet Qeveritare	13	113,580	150,000	-	-	1,331,619	1,595,199
		Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-	250,000	250,000
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
9.1.	66445	Planifikimi urban dhe inspeksioni	13	113,580	150,000	-	-	1,581,619	1,845,199
		Grantet Qeveritare	13	113,580	150,000	-	-	1,331,619	1,595,199
		Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-	250,000	250,000
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
10	730	Shëndetësia dhe Mirëq.Sociale	122	1,290,544	338,373	45,000	-	50,000	1,723,917
		Grantet Qeveritare	122	1,290,544	323,373	35,000	-	50,000	1,698,917
		Të hyrat vetanake	-	-	15,000	10,000	-	-	25,000
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
10.1	73037	Administrata	3	30,455	5,000	-	-	-	35,455
		Grantet Qeveritare	3	30,455	5,000	-	-	-	35,455
		Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-	-
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
10.2	74700	Shërbimet e shëndetësisë primare	119	1,260,089	333,373	45,000	-	50,000	1,688,462
		Grantet Qeveritare	119	1,260,089	318,373	35,000	-	50,000	1,663,462
		Të hyrat vetanake	-	-	15,000	10,000	-	-	25,000
		Huamarrja	-	-	-	-	-	-	-
11	75635	Shërbimet sociale	8	60,200	10,000	5,000	10,000	-	85,200
		Grantet Qeveritare	8	60,200	10,000	5,000	-	-	75,200
		Të hyrat vetanake	-	-	-	-	10,000	-	10,000
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
12	850	Kulturë, Rinë dhe Sport	18	135,820	85,000	10,000	100,000	35,000	365,820
		Grantet Qeveritare	18	135,820	80,000	10,000	30,000	35,000	290,820
		Të hyrat vetanake	-	-	5,000	-	70,000	-	75,000
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
12.1	85028	Shërbime Kulturore	18	135,820	85,000	10,000	100,000	35,000	365,820
		Grantet Qeveritare	18	135,820	80,000	10,000	30,000	35,000	290,820
		Të hyrat vetanake	-	-	5,000	-	70,000	-	75,000
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
13	920	Arsimi dhe shkenca	535	4,093,030	499,914	106,549	60,000	600,001	5,359,494
		Grantet Qeveritare	535	4,093,030	484,914	103,000	-	589,020	5,269,964
		Të hyrat vetanake	-	-	15,000	3,549	60,000	10,981	89,530
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
13.1	92140	Administrata	6	52,300	8,000	-	60,000	-	120,300
		Grantet Qeveritare	6	52,300	8,000	-	-	-	60,300
		Të hyrat vetanake	-	-	-	-	60,000	-	60,000
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
13.2	92750	Arsimi parashkollor dhe qerdhjet	21	168,040	115,000	13,549	-	-	296,589
		Grantet Qeveritare	21	168,040	100,000	10,000	-	-	278,040
		Të hyrat vetanake	-	-	15,000	3,549	-	-	18,549
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-
13.3	93810	Arsimi fillor	406	3,129,065	250,000	50,000	-	600,001	4,029,066
		Grantet Qeveritare	406	3,129,065	250,000	50,000	-	589,020	4,018,085
		Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-	10,981	10,981
		Huamarrja	-	-	-	-	-	-	-
13.4	95010	Arsimi i mesëm	102	743,625	126,914	43,000	-	-	913,539
		Grantet Qeveritare	102	743,625	126,914	43,000	-	-	913,539
		Të hyrat vetanake	-	-	-	-	-	-	-
		Financimi i jashtëm	-	-	-	-	-	-	-

Tab.4.2. Propozim Projektet kapitale 2024 -2026

Nr.	Emertimi i projekteve:	Kodi i Projektit	Buxheti 2024	Vlerësimi 2025	Vlerësimi 2026	Total 2024-2026
	TOTALI :		3,162,761	3,692,795	4,208,619	11,064,175
	ADMINISTRATA KOMUNALE		2,442,261	2,742,795	3,558,619	8,743,675
I	Administrata dhe Personeli		337,000	107,000	202,000	646,000
1	Ndërtimi i Aneksit të objektit të Administratës Komunale	50993		5,000	200,000	205,000
2	Furnizimi me Moblije dhe Pajime		2,000	2,000	2,000	6,000
3	Rregullimi i sistemit të ngrohjes qendrore të objektit të Administratës Komunale	52636	5,000	100,000	-	105,000
4	Ndërtimi i parkingut nëntokësorë për Administratën komunale	50995	330,000	-	-	330,000
II.	Buxhet dhe Financa		165,000	350,000	350,000	865,000
5	Mjetet për bashkëfinancim të projekteve	86245	165,000	350,000	350,000	865,000
III.	Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia		614,313	675,000	1,140,000	2,426,313
6	Ndërtimi i fabrikës për trajtimin e ujit të pijes në Sepetin	52699	6,313	-	-	6,313
7	Ndërtimi i trotuarit në rrugën regjionale Ahmet Kaçiku segmenti Restaurant Natyra-Fushë e Pajtimit, faza I-rë	52705	70,000	250,000	-	320,000
8	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës së fshatrave Llanishtë - Nikoc - Kërbliq - Drenogllavë	43987	5,000	-	-	5,000
9	Rregullimi i rrugës Bob-Kulla Hasanit	46554	100,000	50,000	-	150,000
10	Ndërtimi dhe asfaltimi I pjesës së mbetur të rrugës Ismail Raka, segmenti prej Shtëpisë së Kulturës deri te Xhamia e Dëshmorëve	51628	5,000	5,000	5,000	15,000
11	Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike	52879	100,000	100,000	100,000	300,000
12	Ndërtimi dhe rregullimi i rrjeteve të ujësjellësve	52883	75,000	60,000	150,000	285,000
13	Rregullimi i ndriçimit publik	52809	50,000	40,000	80,000	170,000
14	Ndërtimi i implantit për trajtimin e ujrave të zeza në dalje të pjesës jugore të zonës urbane të qytetit	48261	5,000	-	-	5,000
15	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Idriz Seferi	51631	100,000	-	-	100,000
16	Ndërtimi i objektit për Zjarrefiksesit - Kaçanik	50170	40,000	-	-	40,000
17	Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike	52820	20,000	20,000	50,000	90,000
18	Ndërtimi i kolektorit kryesorë për trajtimin e ujrave të zeza-Nerodime	51045	5,000	5,000	5,000	15,000
19	Asfaltimi i rrugës "Hamëz Jashari" segmenti Silkapor - Rakaj	I ri	5,000	-	-	5,000
20	Projekte të ndryshme infrastrukturore	I ri	-	145,000	750,000	895,000
21	Ndërtimi i garazhës për kamiona për KRM "Pastertia" Kaçanik	I ri	25,000	-	-	25,000
22	Rregullimi i kanalizimit në fshatin Begracë	52174	1,500			
23	Rregullimi i sheshit të qytetit - faza I-rë	51036	1,500			
IV.	Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillimi Rural		50,000	60,000	50,000	160,000
24	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në fshatrat Biqec,Kovaqec dhe Dubravë	52849	50,000	60,000	50,000	160,000
V.	Zhvillimi Ekonomik		335,000	150,000	200,000	685,000
25	Ndërtimi i shkalleve të Guri Shpuar	52893	150,000	-	-	150,000
26	Ndërtimi i parkut rekreativ në zonën turistike Shtrazë	52899	55,000	-	-	55,000
27	Ndërtimi i trotuarit, shtegut për ciklizëm dhe ndriçimit publik në rrugën Murat Lika Shtrazë	51648	85,000	-	-	85,000

28	Ndërtimi i objektit Kullë mbi Lumin Lepenc	I ri	5,000	-	-	5,000
29	Projektet zhvillimore te turizmit	I ri	-	150,000	200,000	350,000
30	Ndërtimi i shtegut të Lirisë	I ri	40,000	-	-	40,000
VI.	Planifikim Urban dhe Mjedisi		804,448	1,310,795	1,581,619	3,624,583
31	Vazhdimi I punieve ne hapsiren publike te Qarshia e Qytetit	51213	20,000	-	-	20,000
32	Ndërtimi i shtretërve të lumenjëve dhe përrockave	53133	150,000	150,000	250,000	550,000
33	Ndërtimi i ures mbi lumin Nerodime dhe mbi hekurudhë	53142	5,000	5,000	-	10,000
34	Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën urbane-Kaçanik	53187	150,000	416,855	381,273	948,128
35	Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve në pjesën rurale-Kaçanik	53198	302,169	733,940	945,346	1,981,455
36	Rregullimi dhe asfaltimi I rrugës që lidhë vendbanimet:Gërllicë-K.Vjetër-Stagovë-Runjevë	48413	5,000	5,000	5,000	15,000
37	Ndërtimi i urave mbi lumin Lepenc	53279	100,000	-	-	100,000
38	Ndërtimi i rrugës dhe trotuarit "Reshat Shehu"	I ri	72,279	-	-	-
VII.	MIRËQENJA SOCIALE		1,500	5,000	-	6,500
39	Ndërtimi i objektit të QPS-ës në Kaçanik	52979	1,500	5,000	-	6,500
VIII.	SHËNDETËSIA		160,000	50,000	50,000	260,000
40	Furnizimi me aparatura për QKMF-ën	I ri	30,000	-	50,000	80,000
41	Blerja e veturës për kujdesin Paliativ	I ri	30,000	-	-	30,000
42	Ndërtimi i depos dhe garazhës në QKMF	I ri	100,000	50,000	-	150,000
XIX.	KULTURË, RINI DHE SPORT		135,000	85,000	35,000	255,000
43	Rregullimi I varrezave të Dëshmorëve dhe Veteranëve të Uçk-së	45087	30,000	30,000	30,000	90,000
44	Rregullimi i tereneve sportive	52208	100,000	50,000	-	150,000
45	Ndërtimi i stadiumit te qytetit "Besnik Begunca"	45064	5,000	5,000	5,000	15,000
X.	ARSIMI FILLORË		410,500	800,000	600,000	1,810,500
46	Ndërtimi i Qerdhes së fëmijëve në Kaçanik të Vjetër	52990	5,000	-	-	5,000
47	Ndërtimi i Qerdhes së fëmijëve në Fshatin Rekë	I ri	5,000	-	-	5,000
48	Ndërtimi i sallës së Edukatës Fizike ne SHFMU "Jusuf Gërvalla"	53275	100,000	-	-	100,000
49	Ndërtimi i sallës së Edukatës Fizike ne SHFMU "Idriz Seferi" në fshatin Bob	I ri	200,000	100,000	-	300,000
50	Ndërtimi i sallës së Edukatës Fizike ne SHFMU "Kadri Zeka" Dubravë	I ri	-	200,000	100,000	300,000
51	Ndërtimi i SHFMU "Emin Duraku" Kaçanik	50211	50,500	450,000	450,000	950,500
52	Furnizim me tabela digjitale per shkollat fillore dhe te mesme	53229	20,000	20,000	20,000	60,000
53	Furnizimi me mobilje dhe pajime të shkollave	88649	30,000	30,000	30,000	90,000
	ARSIMI I MESËM		150,000	100,000	-	250,000
54	Ndërtimi i aneksit të IAAP-Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka	I ri	150,000	100,000	-	250,000

Tabela 4.3. Plani Afatmesëm i të hyrave totale të buxhetit komunal për vitet 2024-2026

Nr.	Përshkrimi	Buxheti aktual 2023	Plani 2024	Vlerësimi 2025	Vlerësimi 2026
a	b		c	d	e
1	TË HYRAT KOMUNALE TOTALE	10,674,689	11,958,983	12,579,771	13,195,938
1.1	TË HYRAT VETANAKE	862,578	924,200	957,045	1,000,530
1.1.1	Tatimi në pronë	250,512	391,545	400,249	417,036
1.1.2	Tatimi në tokë	160,454	80,543	82,079	85,041
1.1.3	Taksat komunale	353,194	341,112	400,000	421,953
1.1.2.1	Licencat dhe lejet	14,097	16,000	20,000	20,000
1.1.2.2	Çertifikatat dhe dokumentet tjera zyrtarezyrtare	28,725	25,000	23,000	20,000
1.1.2.3	Taksat e regj.pajisjeve motorike	68,129	70,000	72,000	75,000
1.1.2.4	Lejet për ndërtesa	126,489	200,000	250,000	276,953
1.1.2.5	Taksat tjera komunale	115,754	30,112	35,000	30,000
1.1.4	Ngarkesat komunale	88,417	101,000	74,717	76,500
1.1.3.1	Ngarkesat regullatore	3,040	10,000	12,000	12,000
1.1.3.2	Të hyrat nga qiraja	6,027	10,000	15,000	16,000
1.1.3.3	Bashkë-pagesat për arsim	34,132	36,000	22,000	23,500
1.1.3.4	Bashkë-pagesat për shëndetësi	6,566	5,000	10,717	10,000
1.1.3.5	Ngarkesat tjera komunale	38,651	40,000	15,000	15,000
1.1.3.6	Të hyrat tjera	10,000	10,000	-	
1.2	TRANSFERET QEVERITARE	9,812,111	11,034,783	11,622,726	12,195,408
1.2.1	Granti i Përgjithshëm	4,603,825	5,130,643	5,511,286	5,868,939
1.2.2	Granti specifik për Shëndetësi	1,474,184	1,508,809	1,584,249	1,663,462
1.2.3	Granti specifik për Arsim	3,734,102	4,395,331	4,527,191	4,663,007



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kačanik
Municipal of Kačanik

01Nr. 60/01-21699/23
Kaçanik, 08.09.2023

PROCESVERBAL

Nga Diskutimi publik me qytetarë, administratorë të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane, OJQ, përfaqësues të shkollave dhe grupe tjera të interesit, organizuar nga Kryesuesi i KK në konsultim me Komitetin për Politikë dhe Financa-KPF.

Diskutimi publik u mbajt me 08 shtator 2023 në katin III në sallën e KK, me fillim pune në ora 11:00.

Evidenca e pjesëmarrësve është si në listën e bashkëngjitur (përfaqësues nga OJQ, grupe tjera të interesit, administratorë të fshatrave, anëtarë të KK, anëtarë nga ekzekutivi i komunës).

Diskutimin publik e kryesoj Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit,
Procesmbajtëse: Makfire Malsiu.

Tema: Propozim Buxheti për vitin fiskal 2024 dhe vlerësimet për vitet 2025-2026.

Kryesuesi i Kuvendit - Kemal Murseli- Fillimisht i njoftoj pjesëmarrësit për aktivitetin e Ekzekutivit të komunës në mbajtjen e dëgjimeve publike për buxhetin, draftin ia ka përcjellë KK ashtu si e përcakton LVL. Gjatë kësaj periudhe është në obligim ligjor organizimi dhe mbajtja e dëgjimit publik e Kryesuesit të KK në bashkëpunim me KPF para se të dalë drafti në KK. Ligji e përcakton qartë që qytetarët bëhen pjesë e vendimmarrjes në dëgjime publike para miratimit final në KK. Buxheti i vitit 2024 është 11,958,983.00€. Shpenzimet buxhetore janë të ndara në 5 shtylla: Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shërbime, Shërbime Komunale; Subvencione dhe Transfere, Investime Kapitale. Për sqarime me të hollësishme mund të na japin, Nënkryetari i Komunës- Sabedin Vishi dhe Drejtori për Buxhet dhe Financa-Bahri Selimi.

Nënkryetar i Komunës- Sabedin Vishi: Ky është diskutimi i fundit i buxhetit. Buxheti i vitit 2024 është: 11,958,983.00€. Ne si ekzekutiv me të gjitha drejtoritë, kemi mbajtur debate të ndryshme për buxhetin, me të gjitha kategoritë, qytetarët, OJQ, këshillat me të mëdha të fshatrave, shëndetësinë, dhe grupet tjera të interesit, jemi munduar me i inkorporuar kërkesat për ndarje buxhetore. Në listën e prioritete është bërë orientimi i tyre, nuk d.m.th. që nuk ndryshon deri me 30.09.2023. Krahastuar me buxhetin 2023, kemi rritje të buxhetit për 12.03%. Sqarimet i jep me të detaje drejtori i DBF. Kërkoj nga ju t'i jepni kërkesat për orientime e juaja të projekteve, në përputhje me buxhetin. Kërkesat janë të gjitha të arsyeshme, por ne do të mundohem me iu dhënë prioritet atyre me të nevojshme.

Drejtori i DBF- Bahri Selimi: Sqaroj për buxhetin e projektuar për vitin 2024 dhe vlerësimet për vitet 2025-2026 dhe diskutimet publike të mbajtura nga ekzekutivi i komunës. Buxhetin e kemi në kornizat finale. Buxheti i vitit 2024 është 11,958,983.00 €,

kemi ngritje për 12.03%. në masë monetare 1, 284,294.00€, e cila rritje shkon në paga dhe mëditje për shkak të ndryshimit të Ligjit të pagave. Për kundër kësaj, jemi munduar në kategoritë tjera të bëjmë kurse, që shkalla e Investimeve Kapitale(IK) mos të bie nën nivelin që ka qenë. Për Investime Kapitale (IK) i kemi nda 3,162,761€, kemi ngritur IK duke pa kërkesat e juaja të arsyeshme në dëgjime publike. Shpërndarja buxhetore është si vijon: Paga dhe Mëditje, 6,759,179€, Mallra dhe Shërbime,1,421,513€, ShërbimeKomunale,200,000€,Subvencione dhe Transfere, 415,529€. Listën e projekteve kapitale të planifikuara për vitin 2024, drafti na përcjellët neve me ndonjë ndryshim dhe finalizohet për KK, kështu që shfrytëzoni këtë rast për diskutim.

Kryesuesi i Kuvendit-Kemal Murseli: I dëgjua sqarimet e ekzekutivit të komunës, e hapi debatin:

z. Naser Murseli- Administrator i f. Doganaj: Në listën e prioriteteve është kodi: Ndërtimi i trotuarit në rrugën “ Ahmet Kaçiku”, nga segmenti i restorant “Natyra”- “Fusha e Pajtimit” ku janë ndarë, 70,000€. Propozoj që këtij kodi t’i shtohet edhe shuma 100,000€ në fazën e I, ndërkaq shtoj se rruga është e frekuentuar, për shkak të zhvillimit të veprimtarive të bizneseve etj., kalimi i fëmijëve për në shkollë në këtë rrugë, paraqet rrezik për ta, kur dihet se ka pasur edhe aksidente me fatalitet në atë pjesë.

z. Kemal Murseli-Kryesues i Kuvendit: Mbrëmë me Kryetarin e Komunës Besim Ilazi, patëm një takim me komitetin e bizneseve, ku e kanë paraqitur si kërkesë shumë të arsyeshme, për shkak se në këtë aks rrugorë operojnë mbi 90 biznese me mbi 500 punëtorë, pa trotuar dhe ndriçim publik. Arsyeja e komunës është se ajo rrugë është nën administrimin e ministrisë, dhe kjo nuk është bërë që 23 vjet, andaj është mirë që të llojmë për këtë çështje, sepse ka pasur raste edhe me fatalitet. Meqë jam banor i asaj ane, edhe unë po e paraqes si nevojë dhe kërkesë, për shkak se është rrugë e frekuentuar dhe me rrezikshmëri.

z. Vehbi Berisha – f. Runjevë: Unë kam fjalë miradije për punën e KK, sepse çdo rrugicë është shtruar me asfalt. Kur është bërë kanalizimi në fshatin Runjevë është veçuar lagjia “Ukë Meta”, arsyet i dini ju, ndërsa gjendja është e mjerueshme. Unë mendoj që disa probleme mund të kenë zgjedhje për arsye se kanalizimi në këtë lagje është shkaktarë kompania që i ka dhanë këto shtylla për ndriçim publik, uji vazhdimisht rrjedh në rrugë edhe era është pa durueshme. Aty ka shtëpi, po thuajse që një vit banorët janë të mllëfosur kërkoj që ta mbyllni atë gyp të kanalizimit. Tjetër problem është ura te shkolla shumë ngushtë, është ndërtuar në vitin 1982, kur dihet se kalojnë makineritë të rënda ku ajo urë është në rrezik për shembje. Kërkesë tjetër mendoj që është për nxënësit për një trotuar i cili do të shpëton jetën e nxënësve në fshatin Runjevë. Preventiva është shumë me rëndësi edhe në qytet sinajlistika të çerdhja e vjetër ku po ndërtohet sheshi, aty rruga është asfaltuar vetëm një shtresë, rruga një kahesh ka një pamje jashtëzakonisht të dobët.

z. Fatmir Bunjaku- Përfaqësues i f. Biçec- Anëtar i KK -PDK: Kërkoj të hynë në prioritet të buxhetit, projekti: Zgjerimi i rrugës së dëshmorit, ‘Fadil Bunjaku”, sepse rruga për momentin nuk i plotëson kushtet për ato lagje që i përfshinë. Kjo rrugë përfshinë 4 lagje deri të lagja Shorra, përmes së cilës udhëtojnë nxënësit e këtyre lagjeve.

znj. Ardita Rrahmani- Anëtare e KK - LDK: I kam 2 kërkesa:

1. Rruga “Malsor Dashi” që lidhë Dushkajën me f. Stagovë konkretisht deri varrezat e reja të qytetit, rrugë kjo e cila nuk ka as trotuar as ndriçim publik, ndërkaq zgjerimi i qytetit

nuk ka alternativë tjetër përpos në atë pjesë. Kjo është kërkesë e imja e kamotshme, që 2 vite, ndërkaq e pash që të DSHPE janë edhe 3 kode të reja, por kjo kërkesë po shihet se nuk ka kaluar as në dëgjim publik. Kërkoj nga Ekzekutivi të merret parasysh kjo kërkesë.

2. Kërkoj të ndahet një buxhet Grupit jo formal të grave asambleiste, për zhvillimin e aktiviteteve të saj në vitin 2024. GGA është grup jo formal, ndërkaq funksionon në kuadër të KK. Gjatë vitit 2023 ky grup pavarësisht vullnetit të kryetarit dhe kryesuesit të cilët e kanë pasur përkrahjen e aktiviteteve tona, nuk kemi mundur me i realizuar në mungesë të buxhetit.

z. Nexhmedin Lika-Administrator i f. Strazhë: Kërkoj me hyrë në prioritet: Ndërtimi i dy rrugicave në f. Strazhë me nga 200m gjatësi. Këtë kërkesë e kam nga viti 2020. Kërkoj t'iu epët prioritet këtyre 2 rrugicave, sepse në ato rrugica janë duke banuar 7-8 familje, dhe nëse nuk realizohen, unë nuk kam arsye si me qëndruar përfaqësues i fshatit.

z. Fadil Vishi-Administrator i f. Dubravë: 1. Çështja e ujit të pijes, për kundër që është investuar në vitin e kaluar nga komuna në ujësjellës, uji nuk hyn në rezervar. Kërkoj që këtë çështje me sqaruar me kompaninë e ujësjellësit që e ka në mbikëqyrje, se ata paraqiten se ende nuk kanë vendim për mirëmbajtje të ujësjellësit. Uji derdhet, qytetarët vuajnë për ujë, ndërkaq nuk lejohet me u kyçur në rezervar.

2. Të Projekti me nr. 36. Ndërtimi i shtretërve të lumenjve dhe përroskave, kërkoj me u cekur ndërtimi i shtretërve, të dimë se a jemi të përfshirë në këtë prioritet.

3. Kërkoj të hynë në prioritet: Vazhdimi i ndërtimit të trotuarit prej shtëpisë së Stagovëve, me u bërë edhe Ndriçimi publik në atë pjesë, deri të Varrezat e Dëshmorëve.

4. Një shqetësim që është brengosë-së ditëve të fundit, Brahimi ndoshta është me në ngjarje, edhe unë kam pasur ftesa, me na dhënë sqarim rreth ndërtimit të hidrocentraleve që kanë filluar me u ndërtuar në lumin lepenç. A kanë leje, a kanë pëlqim apo leje nga niveli qendror, çfarë dokumentacioni kanë nga niveli lokal, se ka kërkesë për protestë për çështjen hidrocentralit. Nëse ju i keni lëshuar dokument, ne duhet ta dimë, të bazohemi diku se a është duke punuar krye në veti apo ka dokument prej komunës.

Kemi edhe kërkesa tjera, si të çështja e rrugicave, por për momentin janë këto kërkesa që i potencova.

z. Hysni Terziu - f. Sllatinë: F. Sllatinë është me i prapambeturi sa i përket infrastrukturës. Ka pasur mungesë të rrymës, kemi pasur kërkesa deri në Prishtinë, ata të rrymës kanë dalë në vendngjarje me incizuar gjendjen, por nuk kanë mundur në mungesë të infrastrukturës dhe kanë kërkuar nga komuniteti një traktor me shkuar deri atje. Në këtë kohë mos me pasur mundësi me shkuar automjeti, nuk është në rregull. Buxheti është i vogël, ndërkaq nuk ka projekte për këtë fshat. Kërkesa ime është që projektet që janë imediate, të kryhen menjëherë.

1. Kërkoj që një rrugë e f. Sllatinë që është 500m gjatësi, sivjet të shtohet me asfalt. Është kërkesë e qytetarëve të këtij fshati që të bëhet shtrimi i disa rrugicave deri të shtëpitë e tyre.

2. Çështja e ujit të pijes, edhe kjo është imediate, ujë të pijes nuk ka ky fshat, duhet marrë veprime të nevojshme për me zgjidhur këtë problem, në mënyrë që qytetarët që janë aty mos të largohen nga vendi dhe mundësia e kthimit të atyre që janë larguar nga ky vend, se ekziston mundësia të kthehen, nëse krijohen kushtet infrastrukturore.

z. Kemal Murseli- Kryesues i Kuvendit: Ne jemi komunë e vogël me buxhet të vogël, ndërkaq këtë vit vitin paraprak dhe vitin vijues nuk kemi pasur ndonjë projekt që është mbështetur nga niveli qendror. Nevojat dhe kërkesat janë të mëdha, buxheti është i vogël

për IK. Vullnet ekziston i organeve të komunës për miratimin e çdo kërkesë, por duhet miratuar ato që janë me prioritet, se duhet të silllemi brenda mundësive buxhetore.

z. Sabedin Vishi-Nënkryetar i Komunës: Po ia nisi prej kërkesave të fundit: Çështja e rrymës, nuk është në kompetencë të komunës. Të çështja e rrugicave dhe kanalizimeve, 100-200 metra, kemi kode të veçanta ku i përfshijmë gjatë vitit rrugicat dhe kanalizimet. Të uji i pijes, në vitin 2022, i kemi ndarë mjete për ujë, kemi investuar fillimisht në 7 fshatra, se probleme se është përfshirë edhe uji i përroskës gjatë të reshurave atmosferike. Janë vendosur 900 ujëmatës, janë pastruar të gjitha basenet, basenet janë mbyllë dhe i ka kaluar bifurkacionit. Nëse nuk e ka me letra bifurkacioni, atëherë pse po i eliminon defektet kur po ndodhin. Ka mbetur me ua bartë kompanisë edhe disa asete të pusi që është hapë në vitin e kaluar, ndërsa ne nuk mundemi me iu përzier në fushën e menaxhimit, kompania i jep llogari nivelit qendror. Derisa nuk paguajmë, ujë keqpërdoret dhe vendet në lartësi mbesin pa ujë. Sivjet janë ndarë 150,000€ për ujë, vitin tjetër 75,000€. Të trotualet, përroskat janë ndarë 150,000€. DUKMM duhet t'i sjell projektet në përputhje me këtë vlerë që e kemi. Në Strazhë, të kërkesat e Nexhmedin Lika, rrugicat bëhen vitin tjetër. Të kërkesa e znj. Rrahmani, rruga "Malsor Dashi" është e arsyeshme, nuk e di a do të mundemi me futur apo jo në këtë projekt buxhetor. Të kërkesa për ndarje të mjeteve Grupit të grave asambleiste, për zhvillimin e aktiviteteve të tyre, mos të mbetet faji te ne se vjet kërkesa ka qenë e vonuar, sivjet është me kohë. Të kërkesa e Fatmir Bunjaku, ka qenë fillimisht kërkesa për kanalizim në f. Biçec, ka dalë gjeodeti, se a ka probleme pronësore juridike dhe kemi me punuar në këtë drejtim. Të kërkesa e z. Berisha, a keni pasur me herët kërkesë me shkrim, sa është gjatësia, se i kemi kërkesat në kuadër të kodit që e potencova.

Vehbi Berisha- f. Runjevë:: Rruga është 300-400 metra, ndërkaq kërkoj të merrni veprime të nevojshme që trotuari i kësaj rruge të realizohet dhe ndriçimi publik.

z. Sabedin Vishi- Nënkryetari i Komunës: Në rregull, e shënova këtë projekt në kuadër të projektit të rrugëve të vogla. Të pyetja e Naser Murseli, çështjen e trotuarit në rrugën "Ahmet Kaçiku" e elaboroj edhe Kryesuesi i KK. Rruga është e frekuentuar, ka biznese që afarojnë që gjenerojnë vende të reja të punës, është afër autostradës, kërkesa është e arsyeshme, kjo kërkesë është edhe e disa fshatrave tjera të asaj zone. Deri tani nuk kas hyrë në prioritet, sepse rrugët regjionale i ka ministria. Ne kemi marrë vendim i kemi ndarë 70,000€ dhe do të shtohen mjete për këtë projekt, mbështetje nuk kemi nga niveli qendror. Ka kërkesa nga viti 2018-2019 për të cilat qeveria nuk ka proceduar mjete me i përfunduar. Kërkesat janë të arsyeshme, çështja është e buxhetit të limituar, 3,162,761€ se mjetet tjera shkojnë për kategoritë tjera shpenzuese buxhetore.

z. Fadil Vishi-Administrator i f. Dubravë: Të çështja e ujësjellësit, marrëveshja me Bifurkacionin nuk është e qartë. E lexoj marrëveshjen, ndërkaq shtoj se drejtori nuk e pranon se ka bërë marrëveshje. Qytetarët e komunitetit tonë kanë shpreh gatishmëri me dalë me lidhë vet ujin, pa marrë parasysh koston dhe pasojave ligjore.

z. Qendrim Vogliqi- Administrator i f. Gërlisë e Epërme: Fillimisht kërkoj me ditur se a po mbahet procesverbal për debatet e organizuara, sepse kërkesat tona po janë të përgjysmuara, dhe do ishte mirë të kishte edhe video incizim.

Kërkesat:

1. Janë do kërkesa nga viti 2018: Ndërtimi i rrugicave. Kërkesat i kanë DUKMM dhe DSHPE.

2. Ndërtimi i kanalizimit atmosferik, të pjesa e varrezave të fshatit, pjesa ku janë dhënë pronat në shfrytëzim, është mirë me ua krijuar infrastrukturën bizneseve sepse gjenerojnë vende të reja të punës.
3. Ndriçimi publik që e kemi bërë me vet kontribut që 2 muaj është ndalë, ndërkaq ndriçimi i ri publik, nuk është bërë funksional.
4. Inspektorët duhet me bërë verifikim çështjen e kanalizimeve, sepse ka shtëpi që nuk janë të kyçura fare në kanalizim, sepse kanalizimet a atyre shtëpive po shkarkohen në ambiente të hapura dhe nëpër rrugë.
5. Të Projektet kapitale 2024-2026, ka projekte të mira, ka disa që na duhen sqarime, si:

-Projekti i asfaltimit të rrugës “Hamzë Jashari” segmenti të fabrika e Silcaporit-Rakaj, kërkoj sqarim a është shpallë zonë interesi ajo pjesë, ndërkaq sa e di unë, aty nuk ka banim.

- Projekte të ndryshme infrastrukturore, 895, 000€, a hynë në këtë kod buxhetor projektet infrastrukturore, si; kanalizimet, rrugët.

-Ndërtimi i objektit kullë mbi lumin Lepenc. Çka nënkupton ky projekt?

-Ndërtimi i rrugës për në Luboten. Edhe këtu është mirë dikush me dhënë një sqarim.

-Rregullimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale në Kaçanik. është mirë me i specifikuar se në cilat fshatra do të asfaltohen rrugët, që mos të fokusohen krejt me një fshat e fshatrat tjera me mbetur anash.

Unë në një debat publik kam thënë: Në ato fshatra ku nuk ka kanalizim dhe ujësjellës, nuk ka nevojë fillimisht të asfaltohen rrugët, pa iu dhënë prioritet fillimisht ujit dhe kanalizimit. Për derisa kolegët i mi këtu kërkojnë kanalizim, unë nuk kërkoj asfalt, pa iu bërë kanalizimi atij komuniteti.

-Ndërtimi i depos dhe garazhë në QKMF, 150,000€. Me ka ra me pa shpesh të evidentuar këtë projekt. Nuk e di a ka përfunduar ky projekt dhe sa garazha janë ndërtuar?

Tani po ndalem të projektet e DKRS:

Kur ishte festa e 7 shtatorit” Ditës së Kushtetutës së Republikës së Kosovës të vitit 1990, dje ishte 33 vjetori, ndërkaq pati shumë postime për këtë datë, ndërkaq në anën tjetër, po të shikojmë sallën ku u shpallë Pavarësia e Kosovës, sala e vogël e shtëpisë së Kulturës “Xheladin Kurtaj” është në gjendje të mjerueshme, nuk është arritur që sa vjet me u bërë një restaurim i saj. Ajo sallë donë restaurim apo bërë muze. Kërkoj që restaurimi i sallës së vogël në shtëpinë e kulturës me e futur në prioritet. Pavarësisht subjekteve politike që na përfaqësojnë në KK, është mirë këtë projekt me shtyrë përpara. Nuk po them me anuluar projektin: Rregullimin e varrezave të dëshmorëve dhe veteranëve, e kisha anuluar projektin: Rregullimin e terreneve sportive. Edhe Projekti i ndërtimit të stadiumit të qytetit, shumë 15,000€ nuk janë shumë këto mjete, se stadiumi i plotëson kushtet se është i ndërtuar.

z. Sabedin Vishi- Nënkyetar i Komunës: Çështja e sallës ku u shpallë Kushtetuta e Republikës së Kosovës, është bërë lyrja dhe ndriçimi i sallës, ndërkaq është monument i mbrojtur dhe nuk kanë lejuar karrikave me ua humbur origjinalitetin. Ju jeni profesionist dhe në momentin që një objekt kulturor shpallet trashëgimi kulturore, nuk lejohet me bërë ndërhyrje. Drejtoresha ka pasur gatishmëri me investuar, por çështja është se ka hasur në probleme. Çështja e stadiumit, projekti ka ngelur në gjysmë, është projekt i ministrisë, i kemi paraparë 5,000€, jo 15,000 €, po presim nga ministria donacione për tre vjet për realizimin e projektit. Krejt projektet me kode nga 5,000€ janë me ua mundësuar projekteve me u koduar, ndërkaq presim investime nga niveli qendror.

Rruga" Hamzë Jashari" sivjet janë lidhë 2 kontrata me 2 biznese të reja për zhvillimin e bizneseve, është teren i mirë për operim të bizneseve, se kur na vijnë biznese serioze, ne jemi të gatshëm me iu përgjigjur kërkesave të tyre në afate ligjore, në mënyrë që të gjenerojmë vende të reja të punës dhe të administrojmë zhvillimin e komunës, që ka qenë prioritet i kryetarit të komunës. Kjo rrugë është lënë kod buxhetor, në mënyrë që me pasur mundësi me investuar që bizneseve me ua krijuar infrastrukturën për me operuar.

Të mirëmbajtja e ndriçimit publik, është e vërtetë se kemi pasur probleme, të ju jo, por kemi pasur probleme që 8 muaj në procedura, në momentin që fitohet projektin me ligj të prokurimit kontratën kornizë për mirëmbajtje një operator, nëse ka ankesa, duhet të pritët afati ligjor i ankesave. Ankesat kanë shkuar në OSHP. Jemi detyruar me bërë një kontratë nën shumën 10,000€ që është e lejueshme, që se paku me përmirësuar shërbimin te rrugët kryesore dhe janë përmirësuar apo janë në përmirësim e sipër. Ndërkaq nuk kemi kontratë përfundimtare me asnjë operator, për shkak të procedurave, ndërkaq kemi mbetur keq sa i përket mirëmbajtjes, se vetëm në ndriçimin publik të rrugës së Dubravës mungojnë mbi 40 drita. Të Projekti, Ndërtimi i objektit kullë mbi lumin lepenç, ky është atraksion për zhvillimin e turizmit, se Kaçaniku ka potencial për zhvillimin e turizmit. Ky projekt është në vendin ku bëhet bashkimi i dy lumenjve, drejtoresha e ka pasur një takim me zëvendësministrin e zhvillimit ekonomik

znj. Pranvera Loku-Zharku- Drejtor i Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm: Ky projekti, Ndërtimi i rrugës për Luboten, projekti është dërguar në ministrinë e zhvillimit ekonomik, për prezantim në konferencë me donator dhe kjo është arsyeja që e kemi futur si kod buxhetor, që në rast së mbështetët nga donator. Këto projekte kanë qenë edhe në platformën e qeverisjes Ilazi.

z. Bahri Selimi- Drejtor i Buxhetit dhe Financave: Projekti me nr. 47, ka të bëjmë të shëndetësia. Të shëndetësia Qëndrim, nëse shtojmë apo zvogëlojmë mjetet buxhetore, nuk mundem me i shpërndarë në projekte të sektorëve të tjerë, sepse është grant specifik i shëndetësisë. Granti specifik i shëndetësisë dhe granti specifik i arsimit nuk munden të shpërndahen në projektet e përgjithshme që i kemi. Ky projekt është projekt i ri, nuk është përmend ky projekt, bëhet fjalë për t'i ruajtur pajisjet themelore: asetet, veturat, autoambulancat , që për momentin nuk kanë vend të mbrojtur. Ky projekt edhe nëse hiqet, mjetet përsëri mbesin në projekte të shëndetësisë. Granti specifik i arsimit, binduni se 50,000€ na i lejon formula për me financuar arsimin për investime kapitale. Të arsimit fillor në vitin 2024 janë ndarë 325,000€, të arsimit i mesëm 150,000 €, ndërsa me formulë janë 50,000€ me u financua me buxhet komunal. Përgjegjësia për ndërtimin e shkollave është e ministrisë, por duke e pa që kanë çaluar në këtë drejtim, ne po mundohemi me bërë investime me buxhet komunal. Kontributi i juaj në debate publike, është i çmuar për mua, i prek do çështje shumë të rëndësishme, e përmende që dikush nuk ka ujë dhe kanalizim, mirëpo buxheti i po shpërndahet i alokuar në shumë projekte, po mbesim pa i kryer projektet e mëdha, siç është uji i pijes. Po e financojmë projektet që janë në përgjegjësi të nivelit qendror, me mjete nga niveli komunal, kështu që detyrat që janë në përgjegjësi tonë, po na mbesin pa i kryer, për shkak se nuk po përkrahemi nga ministria.

znj. Hafize Sallahi- Drejtor i Kulturës, Rinisë dhe Sportit: Përgjigje për trashëgiminë kulturore për Qëndrimin dhe për të gjithë qytetarët, se po keqkuptohemi sa i përket trashëgimisë kulturore. Unë vjet kam ndarë një buxhet nga Mallrat dhe Shërbimet për sallën 7 shtatori, për renovimin e saj, por qendra e rajonit të Ferizajt për trashëgimi kulturore nuk lejon asnjë intervenim të objekteve që janë të mbrojtura nga trashëgimia kulturore. Salla e 7 shtatorit është trashëgimi kulturore nga viti 2010, dhe është lejuar ë

vetëm ngjyrosja dhe ndriçimi artificial i sallës. Për karrikat e kemi bërë kërkesën në ministri, por nuk lejohet se duhet me u gjetur i njëjti stof dhe ngjyra e njëjtë, nuk ka prodhim më të atij lloj stofi, se është i vitit 1985. Tani jemi në hartim të një projekti, me na lejuar ministria se ndryshuar se paku materialin, se ngjyra nuk lejohet. Të objektet që janë në trashëgimi kulturore nuk lejohet asnjë intervenim. Në f. Gllaboçicë është një objekt i mbrojtur i vitit 1930, që paraqet rrezik për banorët e asaj lagje, kam bërë kërkesë në ministri, mirëpo deri tani nuk është bërë asnjë intervenim. Të çështja e kodit për stadiumin e qytetit, janë 5,000€, për intervenimet që i përkasin komunës, si: bankinat, rrjetat, rrethojë, ndërrimi i ndonjë dere etj. se Federata e sportit nuk lejon me u zhvilluar lojërat nëse fusha i plotëson kushtet, për atë ndahet buxhet çdo vit, ndërkaq projekti madhor është i ministrisë, deri me tani nuk kemi asnjë njoftim.

z. Brahim Dalloshi-Administrator i f. Soponicë- Sllatinë: Për çështjen e ndërtimit të rrugicave të f. Sllatinë, unë kam pasur kontakte me dy drejtorë: Ramadushin dhe Qamilin, nuk kam çka me fol për këtë çështje, pasi që drejtorët nuk janë prezentë në debat. Për çështjen e hidrocentraleve që e ngriti Fadil Vishi, është një problem i madh që ne as vet nuk po e dimë sesi me vepruar. Po iu njoftoj se në ditën e hënë e kemi organizuar një protestë me qytetarë, kundër punë kryesit, unë po e quaj uzurpatorit të lumit, në të cilin lum rrjedhin edhe disa kanalizime. Nëse uji hynë në atë gyp, atëherë në banorët e asaj ane duhet të largohemi nga ajo pjesë. Si administrator i fshatit, kërkoj të merrni pjesë në atë protestë, që të protestojmë kundër punë kryesit të hidrocentralit mbi lumin lepenç.

z. Kadri Dardhishta- Administrator i f. Këshillit të qendrës urbane-Zona I: I kam do kërkesa jo të mëdha që i kam përsëritur në takime publike, si - Zgjerimi i rrugës për këmbësorë në rrugën "Avdrrahim Shehu", sepse paraqet rrezik për këmbësor sidomos për fëmijë. Ky projekt nuk është shumë i kushtueshëm. -Një kërkesë e kemi pasur për gypa të xhamia, gypat na i ka sjellë drejtori Ramadush Osmani, tani çështja është e hapjes së kanalit, me pasur mundësi me na e siguruar hapjen e kanalit me ekskavator, se nuk po kemi mundësi me mjete vetanake, se gypat kanë ngelur mbi sipërfaqe. Nëse vendosen ata gypa, rruga "Kijani Bela " është zgjeruar, me bërë edhe për këmbësor dhe njëfarë korite me i futur gypat. Kjo nuk kushton shumë, nëse nuk ka mundësi me u realizuar në këtë vit, vitin tjetër me realizuar. Një kërkesë e kam të rruga "Shefket Ferra", të pjesa lartë që ka ngelë pa shtruar, ishte thyer kapaku i kanalizimit. Kërkesën e kam adresuar në komunë, ndërkaq me thanë se e ke adresuar në adresë të gabuar. Gypi është mbushur dhe krijon erë të kanalizimit.

z. Sabedin Vishi-Nënkryetar i Komunës: Në rast se janë në menaxhim të ujësjellësit, e kanë në obligim kompania, se fatura i paguhet për ujë dhe kanalizim kompanisë dhe çdo prishje e rregullon kompania. Nëse nuk janë në menaxhim të kompanisë, atëherë është në kompetencë të komunës.

z. Kadri Dardhishta- Administrator i f. Këshillit të qendrës urbane-Zona I Unë si kërkesë e kam adresuar, ndërkaq nuk e di se në menaxhim të kujt është. Me vjen mirë që është punuar, se nuk mundemi me thënë që nuk është punuar, por nganjëherë do çështje mbesin për pak. E pash që ishte duke u ndërtuar një muri atje, dhe kjo është shumë mirë. Çështja e rrugës është shumë me rëndësi se kalojnë fëmijët, ndërkaq një kërkesë me kanë adresuar me pas mbrojtëse ajo rrugë, se rrugët diku po janë me trotuar, diku jo.

znj. Ardita Rrahmani- Anëtare e KK- LDK: E kam një kërkesë për DA, ka të bëjë me Çerdhen publike, e cila i plotëson të gjitha kushtet, ndërkaq e di se ka kërkesë nga stafi për

shtimin e shtretërve për fëmijë, për arsye se ka mungesë se është numri i vogël, përndryshe kushtet në çerdhe të fëmijëve janë fantastike.

znj. Florina lika-Vishi- Anëtare e KK-PDK : Duke ditur se numri i fëmijëve me nevoja të veçanta, dita ditës është në rritje, kërkoj nga ju ndarjen e një buxheti të veçantë për këtë kategori, që t'iu mundësohet arsimimi dhe edukimi me i mirë dhe gjithëpërfshirës, duke ditur se drejtorët e shkollave kanë buxhet jo të mjaftueshëm, ndërkaq kërkesat dhe nevojat e tyre janë të papërballueshme për drejtorinë.

z. Qëndrim Vogliqi- Administrator i Gërlicës e Epërme: Të ndriçimi publik në f. Gërlicë, u keqkuptuam me nënkryetarin, ndriçimin publik e mirëmbajmë ne vet komuniteti. Ndriçimi i ri që është duke u bërë, e kanë ç kyçur ndriçimin e vjetër. Duhet me marrë veprime të nevojshme për me pasur ndriçim publik komuniteti. Tjetra, me ua mundësuar bizneseve krijimin e infrastrukturës, ashtu siç po ua mundësoni të rruga “Hamzë Jashari” me ua mundësuar edhe atyre të Natyrës, se aty janë kompanitë me të mëdha të cilat gjenerojnë vende të punës- mbi 70 punëtorë, e jo bizneset me mjetet e veta me krijuar infrastrukturën.

z. Kemal Murseli-Kryesues i Kuvendit: Rruga “Hamzë Jashari” është kategori e veçantë, është rrugë e cila ekziston kaherë, rrugë që e lidhë Kaçanikun dhe Ferizajn. Ajo rrugë nuk bëhet vetëm për biznese, por bëhet për krejt qytetarët e komunës se është e frekuentuar dhe kur nuk kanë ekzistuar rrugët tjera, përmes asaj rruge kanë shkuar qytetarët në Ferizaj. Kjo rrugë lidhë disa fshatra, Doganaj, Rakaj, Koxhaj. Bizneset për të cilat po flisni ju, e kanë asfaltin 20m afër, ndërsa kjo rrugë me km. Në momentin që KK ka vendosur me bërë zonë ekonomike atë pjesë, është e logjikshme të bëhet e qarkullueshme. Kërkesa ime ka qenë që ajo rrugë me u ndërtuar deri në Gërlicë dhe me u lidhë me rrugën e Ferizajt, se kjo rrugë i lidhë dy komuna. Është rrugë me rëndësi për komunën tonë, por kostoja e madhe na ka lënë deri sot pa e ndërtuar.

z. Qëndrim Vogliqi- Administrator i Gërlicës e Epërme: Pyetje për drejtoreshën e DKRS, që tha se nuk restaurohet salla e vogël të shtëpia e kulturës, për arsyet e cekura. Unë me profesion jam inxhinier dhe nuk ka punë që nuk mund të kryhet, vetëm duhet me u angazhuar. Rast konkret i restaurimit të objektit të trashëgimisë kulturore është, shkolla e parë e gjuhës shqipe në Stubëll të Vitisë.

znj. Laureta Vogliqi-Gërlicë e Epërme: I ceku edhe Qëndrimi, rregullimin e varrezave të dëshmorëve dhe rregullimi i terreneve sportive. Unë si artiste që jam e kësaj fushe, po e shoh se, nëse rregullimi i varrezave të dëshmorëve hynë në pjesën kulturore, atëherë kjo duhet me kaluar në kategorinë e restaurimi të trashëgimisë kulturore të Kaçanikut. Rregullimi i terreneve sportive, a hynë kjo në pjesën kulturore, besoj se këto dyja kalojnë në DSHPE, se kemi të bëjmë me shërbime publike. Sa i përket OJQ që unë e përfaqësoj, nëse unë jam paraqitur me aktivitete kulturore me projekte, çfarë duhet me bërë unë që me kaluar ai projekt.

z. Rrustem Zenuni- Përfaqësues i f. Duraj-anëtar i KK-PDK : Për mua shqetësim paraqet lista e gjatë e projekteve me kode. Ky është problem i madh, pasi që niveli qendror veç sa nuk na ka fshirë prej hartës buxhetore. Në vitin e kaluar kam pasur si kërkesë çështjen e ndërtimit të trotuarit prej Fushës së Pajtimt deri të restorant Natyrës, dhe nuk kam dashur me qenë as pjesë e seancës kur është shqyrtuar buxheti. Për neve të cilët jemi të asaj ane, e dimë rëndësinë e atij trotuari dhe rreziqet që mund të ndodhin. Të ky kod mendoj se shuma 70,000€ janë të pamjaftueshme. Mendoj se duhet bërë një rishikim, e tha edhe administratori i f. Doganaj. Në këtë shumë buxhetore të këtij projekti,

duhet patjetër me ndërhyrë. Vitin e kaluar e kam pasur kërkesë: rregullimin e terreneve sportive në f. Duraj. Këtë kërkesë e kam ngritur edhe ne debatin e kaluar, ndërkaq nuk është pashë në listë që është futur si kod. Kërkesë tjetër, është rregullimi i rrugicave f. Gabrricë dhe Elezaj, se kanë mbetur disa në gjysmë, besoj se me mundësitë që i kemi mund të bëhet diçka. Kërkesë tjetër, rregullimi i rrugës në f. Semajë dhe f. Gaçkë. Është punuar shumë në Semajë, por çështja është se duhet intervenuar ende që mos vjen deri të zbrazja e fshatit.

z. Sabedin Vishi Nënkyetar i Komunës: Sa i përket fushave të terreneve sportive, Rrustem kërkesat janë atë arsyeshme, por në përputhje me buxhetin. F. Duraj nuk mundemi me i dhënë prioritet, se këto janë për fusha të hapura. Për derisa të ju jemi në prag të përfundimit të sallës sportive, dikush me pasur edhe sallës të brendshme edhe të jashtme, duhet me përfshirë diku ku nuk kanë as sallë të jashtme as të brendshme. E kemi nisur me terrene sportive të jashtme, sivjet e përfundojmë terrenin sportiv të halla sportive. Kërkesat për rini, kulturë dhe sport, i marrim parasysh. Në vitin e kaluar ka pasur një kërkesë për kombi-bus për nevoja të rinisë, kulturës dhe sportit, sivjet është duke u realizuar. Të kodet buxhetore, është e vërtetë se janë tepër kode buxhetore që u theksua, mbetet me u diskutua. Të rritja e mjeteve për trotuar, e dhashë përgjigjen, por nuk me paske dëgjuar. Të çështja e kalimit të projekteve të OJQ që e përmendi Laureta, është thirrja publike për subvencione, deri tani të gjitha OJQ i subvencionojmë. Për vitin vijues, janë rritur subvencionet, bëhet thirrja publike dhe me projekte të arsyeshme, subvencionohen OJQ. Me Qëndrimin e kuptuam. Të çështja e ndriçimit publik, ka qenë një pengesë pa përfunduar të rryma, në momentin që përfundon, bëhet lidhja e të dy ndriçimeve publike. Buxheti për fëmijë me nevoja të veçanta, është shumë i arsyeshëm, është mirë drejtorët e shkollave me biseduar se e kanë buxhetin që e bëjnë planifikimin buxhetor, ata munden me bërë kërkesë DA për planifikim buxhetor varësisht prej numrit të nxënësve, se në të kundërtën mbesin pa buxhet. Rritja e numrit të shtretërve, është kërkesë shumë e arsyeshme, kërkesa duhet me u bërë të DA dhe besoj se realizohet. Një lajm i mirë që duhet të komunikoj Elmihanes për HANDIKOS, sa është përfunduar një projekt për objekt të HANDIKOS, në vlerë për 60,000€, 30,000€ prej një OJQ Amerikane dhe pjesën tjetër e ka ndarë komuna.

znj. Elmihane Malsiu- OJQ- HANDIKOS: E falënderoj Nënkyetarin për punën që e kanë bërë për objektin e HANDIKOS, besoj se ka me përfunduar shumë shpejtë. Arsyjeja që po e marrë fjalën nuk është kjo, por çështja e objektit të QPS që është parapa. Ju e potencuat që nuk keni grante prej qeverisë që sa vite, e që projekti i QPS ka me zgjatur deri të realizimi. Punëtorët e QPS e kanë ngritur si shqetësim se nuk po kanë ku me mbajtur takime me fëmijë kur kanë takime me prindër, hapësirat aty nuk i plotësojnë kushtet. Do të ishte mirë qemë u bërë një vend jashtë asaj hapësire që ato shërbime me fëmijë me i kryer në atë hapësirë (një dhomë miqësore) diku, se objekti i QPS nuk ka mundësi të përfundoj para tre viteve. Ata të QPS nuk qenkan prezentë, ndërsa e kanë ngritur vazhdimisht këtë shqetësim. Tjetra është, subvencionet, në DSHMS nga 2015 asnjëherë nuk janë ngritur me tepër se 5,000€. Me pas pasur me tepër buxhet në këtë drejtori, ndoshta kishte pasur mundësi me intervenuar me i bërë disa ndryshime të cilat kanë nevojë.

z. Bahri Selimi: Shuma 10,000€ janë sivjet dhe 10,000€ janë në vitin e ardhshëm dhe OJQ e HANDIKOS është financuar çdo vit.

znj. Elmihane Malsiu- OJQ- HANDIKOS: Ne jemi financuar nga zyra e Kryetarit.

z. Bahri Selimi- Drejtor i Buxhetit dhe Financave: Juve nuk iu intereson se nga cili buxhet ne i marrim mjetet, se e di për çka e keni fjalën.

Elmihane Malsiu - OJQ- HANDIKOS: Unë për tjetër çështje e pata fjalën, u keqkuptova.

z. Kemal Murseli-Kryesuesi i Kuvendit: Subvencionet orientohen të Zyra e Kryetarit.

znj. Emona Deda nga OJQ- C.M.A NGO: Të çështja e subvencioneve që u tha se janë mbështetë krejt OJQ, se nuk janë mbështetur krejt OJQ. Ne kemi adresuar 2 herë kërkesa, dokumentet kanë qenë në rregull, ndërkaq nuk kemi marrë

Hafize Sallahi- drejtor i DKRS: Në kohën kur e publikojmë thirrjen për subvencione, të gjitha OJQ e komunës së Kaçanikut të cilat kanë vërtetim nga DKRS që janë të regjistruara në komunën tonë, kanë të drejtë aplikimi. Formohet komisioni i cili fillimisht e shqyrton dokumentacionin, pastaj e vlerëson projektin se cilit i jep prioritet. Të gjitha OJQ që kanë qenë të kompletuara me dokumentacion sivjet, janë subvencionuar, por jo aq sa kanë kërkuar, por sipas mundësive që kemi pasur si DKRS. E di rastin e juve, përgjigjen e keni marrë, ju keni bërë ankesë dhe juve iu ka munguar vërtetimi i DKRS. Herën e dytë me duket se keni aplikuar, kërkesa nuk ka pasur të bëjë me DKRS, por me Zyra e Kryetarit, për subvencionim të personave me nevoja të veçanta.

znj. Emona Deda -OJQ- C.M.A NGO: Për të parën e kemi marrë përgjigjen, por në kërkesën e dytë jo.

Hafize Sallahi-drejtor i DKRS: Kërkesa e dytë e juaja, nuk ka qenë në kompetencë të DKRS, nuk kam pasur qysh me ta kthyer përgjigjen, sepse subvencioni ka qenë prej zyrës së kryetarit.

z. Qëndrim Vogliqi- Administrator Gërlica e Epërme: Kur aplikon një OJQ, se herën e parë unë kam qenë menaxher i projektit dhe kur zyrtarët thonë se nuk ka nevojë me marrë atë dokument, atëherë aplikon pa atë dokument. Kur ju e refuzon një projekt që ka të bëjë me rini që me ta ngjallë vendin këtu, ndërsa iu jep para pensionistëve me shkuar ne deti, kjo nuk është në rregull.

z. Kemal Murseli-Kryesuesi i Kuvendit: Për ju vlerësimi është ashtu, jo për ne. Po të ndërpresë se etiketimet nuk lejohen në debat. Sa OJQ është në Kosovë, ne i subvencionojmë OJQ e Kaçanikut. Për atë arsye, kërkohet një vërtetim që është OJQ e Kaçanikut, se ka OJQ shumë të mëdha që t'i marrin krejt projektet.

znj. Hafize Sallahi- Drejtor i Kulturës, Rinisë dhe Sportit: Në rregullore është e përcaktuar kriter që OJQ të janë në komunën e Kaçanikut. E theksoj edhe kryesuesi i KK së nëse e heqim atë kriter, po iu garantoj që aplikojnë OJQ e mëdha, që i përfitojnë këto subvencione që i ndajmë. Kur jam ardhur drejtoreshë, e kam gjetur këtë kriter dhe me ka pëlqyer që me i subvencionuar vetëm OJQ e Kaçanikut. Vërtetimi duhet edhe i ministrisë edhe vërtetimi i komunës, e juve iu ka munguar vërtetimi i komunës. Sa i përket shoqatës së pensionistëve për Shqipëri, ata paguajnë një pjesë të mjeteve nga shoqata dhe një pjesë nga mjetet e tyre dhe tubojnë mjete në bizneset e Kaçanikut, ndërsa ne i subvencionojmë vetëm ditën botërore të moshuarve, e cila është në planin e aktiviteteve të drejtorisë. Krejt komunat e zhvillojnë këtë aktivitet, ndërsa ne vjet e kemi realizuar për herë të parë, Ditën botërore të moshuarve dhe është mirëpritur nga të gjithë qytetarët.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, takimi u mbyllë nga Kryesuesi i Kuvendit në ora 12:50.

Procesmbajtës
Makfite Malsiu

Makfite Malsiu













Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

Kemal Murseli

Kaçanik, 08.09.2023

Lista e Pjesëmarrjes në Diskutim Publik të organizuar nga Kryesuesi i Kuvendit në bashkëpunim me KPF, për temën: Propozim Buxheti i Komunës së Kaçanikut për vitin fiskal 2024 dhe vlerësimet 2025-2026

Nr. rend.	Emri dhe Mbiemri	Përfaqësimi	Nënshkrimi
1.	FADIL VISHI	AD. DUBRAV	
2.	Schemil Hajdoni	Drejtor shkolle - Dubravë	
3.	BESNIK DEMA	A.D. BOB -	
4.	Artan Meziraja	Qytetar	
5.	HASIA SALITU	A.T.M. BASHNICE	
6.	Rrushem Zomeri	A. K. K.	
7.	FATMIR BURSAKU	K. K.	
8.	Emona Beola	C.M.A NGO	
9.	Samet Luma	Drejtor i shkolles - Gllloboqice	
10.	Fitim Telmani	Drejtor i shkolles - Doganaj	
11.	KADRI KREVENJARI	ASAMBLEIST-KOMUNAL	
12.	Florina Lika-Vishi	Asambleiste	
13.	Arditë Prashmani	Asambleiste	
14.	IBRAHIM KRYETAR	DEMOS	
15.	Qendrim Vogliqi	Kryetar i Ish.Gjericë	
16.	AZEM KORAÇI	ADMINISTRATOR	
17.	NEXH MEDIA	LIKA, STRAZHIC	
18.	SHABAN HORUNI	BIÇEC	
19.	Hyshir Tetëz	SLLATINÉ	
20.	Nebo Berisha	Rumjevi	
21.	Laureta Vogliqi	Gjericë e Epërme	

22.	FATMIR LUTA	AD. FSHIVAJË - GAJRE	<i>[Signature]</i>
23.	Adnan Krasniqi	Adi, Fshatit. ki vjet	<i>[Signature]</i>
24.	Birhan Jkumiqi	Drejtor i SHF-it "Dimitri Risti"	<i>[Signature]</i>
25.	Kaeli DARRI	ADMINISTRATOR	<i>[Signature]</i>
26.	Ibrahim Dasko	ADISTIA Sypori	<i>[Signature]</i>
27.	Leonora Kurti	shtepia e shpreks	<i>[Signature]</i>
28.	Tara Adams	— II —	<i>[Signature]</i>
29.	Elmitiane Malsiu	Handikos Kacamik	<i>[Signature]</i>
30.	FATON SHEHU	— II —	<i>[Signature]</i>
31.	Fatlum Guri Selim		<i>[Signature]</i>
32.	Dardana Dauti	DAP	<i>[Signature]</i>
33.	HATIZE SALLAH	DKRS	<i>[Signature]</i>
34.	PRANVERE ZHARKU	DZKET	<i>[Signature]</i>
35.	LUHAD DULLLOVI	DZEHNP-SO	<i>[Signature]</i>
36.	BAHAR SELIMI	D. FINANCARE	<i>[Signature]</i>
37.	Kemal Museli	Kryesues i Kuvedit	<i>[Signature]</i>
38.	Gabodim Vishi	Nenhyctas	<i>[Signature]</i>
39.	Mahfite Mahri	Zyrtar e KK	<i>[Signature]</i>
40.	Naser Museli	Administratori fsh Doganji	<i>[Signature]</i>
41.	Marije Museli	Asistente e Kryesuesit Kuvedit	<i>[Signature]</i>
42.	Zejnula Dulllovi	Zyrtar IF	<i>[Signature]</i>
43.			
44.			
45.			



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01-Nr. 400/01-24272/23
Kaçanik; 14.09.2023

Mbështetur në nenin 40.2 (b.) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të Ligjit nr.03/L-221. – Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, të nenit 15 dhe 16 të Ligjit nr.(Nr.08/L-193) - Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, te nenit 61 të Statutit të komunës, Kryetari i Komunës, propozon KPF-së, këtë:

PROPOZIM VENDIM PËR RIALOKIMIN E MJETEVE BUXHETORE SIPAS BUXHETIT TË VITIT 2023

1. Rialokimi i mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale (fondi 10): Nga nën-programi Administrata dhe Personeli (16328), kodi funksional 0133:

Nga projekti me kod 50995 “Ndertimi i parkingut nentokësorë për Administratës komunale” shuma prej 89,662.00€;

Këto mjete rialokohen në kategorinë ekonomike **Investime Kapitlae** (fondi 10) në nën-programin Administrata dhe Personeli (16328), kodi funksional 0133, në projektin me kod 52636 “Rregullimi i sistemit të ngrohjes qendrore të objektit të Administratës Komunale, shuma prej 89,662.00€.

Arsyetim për rialokimin e mjeteve:

Arsyeja e këtij rialokimi të mjeteve është pasi që gjatë gërmimit të kompanisë kontraktuese janë zbuluar bazamente të mureve të vjetra, të cilat po humbtohen dhe vlerësohen nga komisioni i krijuar nga MKRS, dhe së shpejti po presim të marrim vendimin përfundimtar nga MKRS. Vendim i cili do të definoj me saktësi procesin se a do të mund të realizojmë projektin e planifikuar “Ndërtimin e Parkingut Nëntokesorë” apo e kundërta do të ndalohen punimet përfundimisht në këtë hapësirë.

2. Për realizimin e këtij Propozim Vendimi, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, e cila drejtori të njejtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave Transfereve dhe Punës, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.

Kryetari i Komunës:

Besim Ilazi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01-Nr. 400/01-2423 23
Kaçanik; 14.09.2023

Mbështetur në nenin 40.2 (b.) të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjit Nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, të Ligjit nr.03/L-221. – Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-048 – Për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit, të nenit 15 dhe 16 të Ligjit nr.(Nr.08/L-193) - Për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023, te nenit 61 të Statutit të komunës, Kryetari i Komunës, propozon KPF-së, këtë:

PROPOZIM VENDIM PËR TRANSFERIN E MJETEVE BUXHETORE SIPAS BUXHETIT TË VITIT 2023

1. Transferet e mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale (fondi 10): Nga nën-programi Infrastruktura Rrugore (18028), kodi funksional 0451:

- a) Nga projekti me kod 51645 “Rehabilitimi i dy shetitoreve përgjatë Lumit Nerodime” shuma prej 2,212.00€;
- b) Nga projekti me kod 52820 “Ndërtimi dhe rregullimi i hapësirave publike (te udhekryqi “Te Lushi”-Doganaj, rr.”Avdyl Dura”-Duraj, rr. “Vellezërit Çaka”-Kaçanik dhe rr. “Zylfi Çaka”-Bob, shuma prej 1,791.00€;
- c) Nga projekti me kod 52883 “Ndërtimi dhe rregullimi i rrjeteve të ujësjellësve në lokalitetet Ivajë, Bajnicë-Kaçanik, ne shumë prej 30,000.00€.

Këto mjete transferohen në kategorinë ekonomike **Mallra dhe Shërbime** (fondi 10) në nën-programin Infrastruktura Rrugore (18028), kodi funksional 0451, shuma prej 34,003.00€

Arsyetim i transferove te mjeteve:

Shuma **2,212.00€** te projekti 51645-“**Rehabilitimi i dy shetitoreve pergjate lumit Nerodime**” është mbetje e mjeteve te planifikuara për këtë kod të projektit ngase kontrata e lidhur me OE-në është nën buxhetin e planifikuar. Shuma **1,791.00€** te projekti 58820-“**Ndërtimi dhe rregullimi i hapsirave publike**” është mbetje e mjeteve te planifikuara për këtë kod të projektit ngase kontrata e lidhur me OE-në është nën buxhetin e planifikuar dhe shuma **30,000.00€** e kërkuar për transferim nga projekti 52883-“**Ndërtimi i rrjeteve të ujësjellësit**” është analizuar nga drejtoria shkaku i pamundësisë se implementimit të plotë të kontratës në këtë vit buxhetor si rrjedhojë e problemeve të paraqitura në teren në disa pozicione të caktuara.

Transferimi i ketyre mjeteve buxhetore te kategoria Mallëra dhe Sherbime te drejtorise është e nevojshme për mbulim te aktiviteteteve vjetore permes kontratave aktive te mirëmbajtjes investive (mirembajtja verore dhe dimërore e rrugëve locale, mirëmbajtja e ndriçimit publik, rregullimi dhe mirëmbajtja e sinjalizimit horizontal dhe vertical, mirëmbajtja e hapësirave të gjelbëruara).

2. Për realizimin e këtij Propozim Vendimi, obligohet Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, e cila drejtori të njejtin vendim do ta zbaton në Ministrinë e Financave Transfereve dhe Punës, respektivisht në Departamentin e Buxhetit dhe Departamentin e Thesarit.

Kryetari i Komunës:

Besim Ilazi





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik

01 Nr. 80/61-24306/23
Kaçanik, 15.09.2023

Mbështetur në nenin 29 dhe 30 të Ligjit nr.03/L-040 – Për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28/4 Qershor 2008), të nenit 59 të Statutit të Komunës së Kaçanikut 01Nr.60/01-12895/20 të datës 30.06.2020, të pikës 5 paragrafi 4.3 e Planit të Punës së Kuvendit për vitin 2023, 01Nr. 60/01-32951/23 të datës 29.12.2022, Kryesuesi i Kuvendit me datë 15 shtator 2023, bënë këtë:

PROPOZIM

Që Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me, të merr këtë:

V E N D I M

PËR REALIZIMIN E NJË VIZITE STUDIMORE E ANËTARËVE TË KUVENDIT TË KOMUNËS KAÇANIK, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË DHE NË REPUBLIKËN E MALIT TË ZI

1. Me këtë Vendim, vendoset të realizohet një vizite studimore e Anëtarëve (Këshilltarëve) të Kuvendit të Komunës Kaçanik, në Republikën e Shqipërisë dhe në Republikën e Malit të Zi.
2. Vizita studimore nga pika 1. e këtij Vendimi, realizohet me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe rritjen e bashkëpunimit ndërmjet komunave.
3. Për përgatitjet e nevojshme për realizimin e vizitës nga pika 1. e këtij vendimi do të kujdesen, Kryesuesi i Kuvendit në bashkëpunim me Shefat e GP të përfaqësuara në Kuvendin e Komunës.
4. Shpenzimet për realizimin e vizitës nga pika 1 e këtij vendimi do t'i bartë Komuna e Kaçanikut, ndërkaq do të kujdeset t'i zbatoj, Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
5. Ky Vendim hyn në fuqi sipas nenit 17 të Rregullores (MAPL) Nr. 01/2017 –Për Procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen:

1. Kryetari i Komunës;
2. Kryesuesi i Kuvendit;
3. Drejtoria e Buxhetit dhe Financave;
4. Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murqeli





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr.60/02-24256 /23
Kaçanik, 14.09.2023

Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSBB)

Raporti i punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për 6 mujorin e parë të vitit 2023

I - Takimi i parë i KKSBB-së për vitin 2023 është mbajtur me **23.02.2023**, të cilin e ka udhëhequr Kryetari i Komunës z. Besim Ilazi me këto pika të rendit të ditës:

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut
- 3.Gjendja e rrugëve dhe mirëmbajtja dimërore
- 4.Trajtimi i rekomandimeve nga takimet e KKSBB gjatë vitit 2022
- 5.Të ndryshme

Për gjendjen e sigurisë në komunën tonë ka raportuar Komandanti i Stacionit të Policisë z. Halim Shehu, i cili raportoi mbi gjendjen e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve si dhe ofroi një njoftim mbi sfidat dhe të arriturat për vitin 2022.

Nga ky takim janë nxjerrë këto rekomandime :

- 1.Të inspektohen bizneset lidhur me respektimin e kushteve sipas rregullave në fuqi dhe të tregojnë kujdes maksimal ndaj produkteve që tregtojnë.
- 2.Të merren masa ndaj bizneseve që u shërbejnë fëmijëve produkte të duhanit dhe pije alkoolike.
- 3.Të respektohet ligji kundër pirjes së duhanit në hapësira të mbyllura.
- 4.Të merren masa ndaj pronarëve të lokaleve (kafiterive) të cilët përdorin trotualet për shërbime e reklama.

II - Takimi i dytë i KKSBB është mbajtur me **27.04.2023**, është kryesuar nga Kryetari i Komunës z. Besim Ilazi dhe janë diskutuar tema të ndryshme që prekin sigurinë e

qytetarëve . Për situatën e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve raportoi Komandanti i stacionit të Policisë në Kaçanik z. Halim Shehu, i cili situatën e sigurisë e cilësoi si të qetë. Si shqetësim ai paraqiti gjendjen e pyjeve sidomos të pjesës së parkut nacional e cila nuk po menaxhohet si duhet nga niveli qendrorë.

Pikat e rendit të ditës nga ky takim ishin:

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut
- 3.Menagjimi i Emergjencave -Fatkeqësitë Natyrore
- 4.Informatë për punën e inspektorëve komunal për vitin 2022
- 5.Të ndryshme

Rekomandimet nga ky takim ishin:

- 1.Të ndërmerren masa ndaj pronarëve të bizneseve që ekspozojnë mallrat në trotuare.
- 2.Të bëhet një plan i mirëfilltë për emergjenca dhe për fatkeqësitë natyrore.
- 3.Të pajisen objektet institucionale me aparate për fikjen e zjarrit si dhe të vendosen shenjat orientuese nëpër këto objekte.
- 4.Të vendosen hidrantë në të gjitha lokalitetet që janë në sistemin e ujësjellësit

III - Mbledhja e tretë e KKSBB duke ju referuar edhe Planit të Punës për vitin 2023 është mbajtur më datë 27.06.2023, kryesuar nga Nënkryetari i Komunës z. Sabedin Vishi, me këto pika të rendit të ditës:

- 1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- 2.Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut
- 3.Përgatitje rreth sfidave eventuale gjatë sezonit verorë
- 4.Të ndryshme

Për situatën e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve raportoi Komandanti i Stacionit të Policisë z. Halim Shehu.

Sipas Komandantit të Policisë në këtë periudhë kohore ka pasur rritje të veprave kriminale e si më shqetësuese ai theksoi dhunën në familje dhe dëmtimi i pyjeve në pjesën e parkut nacional ku si pasojë është keq menaxhimi nga niveli qendrorë.

Si sfidë Komandanti i Policisë e paraqiti edhe numrin e vogël të zyrtarëve policorë për shkak të gjendjes së krijuar në veriun e Kosovës ku një pjesë e këtyre zyrtarëve janë të angazhuar në këtë pjesë.

Rekomandimet e nxjerra nga kjo mbledhje ishin:

1. Të ju bëhet presion më i madh nivelit qendrorë për një menaxhim më të mirë të pjesës së Parkut Nacional apo të gjendet një formë për ruajtjen e kësaj pjese nga keqbërësit.

2. Të vetëdijesohen qytetarët për dhënie të informacioneve për parandalim të dukurive negative.

3. Një koordinim më i mirë i institucioneve të sigurisë në parandalimin e dukurive negative në shoqëri

4. Të rritet gatishmëria për sfidat që mundë ti kemi gjatë sezonit veror lidhur me zjarret.

